



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 22.06.2016, ora 11:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Mucmataj.

#### **Mungojne:**

Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja.

#### **Të ftuar:**

Rainer Deville – shef i misionit EURALIUS, Ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Jon Smibert – këshilltar ligjor rezident i OPDAT-it, ambasada e SHBA-së, Ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Aurela Anastasi – Eksperte e nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Sokol Sadushi - Ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Gent Ibrahimimi - Ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm

## HAPET MBELDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Në vazhdim të shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” do t’ia jap fjalën relatorit zotit Majko.

**Pandeli Majko** – Jo vetëm për shkak të seriozitetit të diskutimit, por dhe për arsyet e zbardhjes të diskutimit në vazhdim, shpresoj që kolegët të më mirëkuptojnë se unë do t’i qëndroj pak strikt dhe tekstit të shkruar.

Ky është një nga projektligjet më të rëndësishme të hartuar në kuadër të reformës kushtetuese dhe ligjore në sistemin e drejtësisë. Pra, bëhet fjalë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577 datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ky ligj është miratuar në vitin 2000 dhe nuk ka pësuar asnjë ndryshim deri më sot. Zbatimi i këtij ligji me një shtrirje 16-vjeçare ka nxjerrë në pah jo pak çështje problematike që prekin jo vetëm aspektin funksional, por dhe atë organizativ të Gjykatës Kushtetuese. Megjithëse Gjykata Kushtetuese ka arritur të ushtrojë funksionet dhe kompetencat e saj nëpërmjet këtij ligji të pandryshuar për një kohë të gjatë, kjo nuk e shmang spektrin e gjerë të problemeve të evidentuara në një pjesë të madhe të ligjit, të cilat janë aderuar në këtë projektligj që do të shqyrtohet sot para këtij komisioni.

Siç është evidentuar dhe nga dokumenti analitik për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, ligjit aktual të Gjykatës Kushtetuese i mungon licenca dhe efektiviteti lidhur me disa aspekte kryesore, si: procesi i emërimit të gjyqtarëve kushtetues, i cili është ndryshuar dhe në nivel kushtetues, procesi disiplinor i gjyqtarëve kushtetues i cili parashikohet për herë të parë, procedurat e veçanta të shqyrtimit kushtetues të cilat pjesërisht rezultojnë të jenë plotësuar dhe pjesërisht të parashikuara rishtas, si dhe çështje që lidhen me aspekte të tjera të veprimtarisë funksionale dhe organizative të Gjykatës Kushtetuese. Këto probleme të pasqyruara në dokumentin analitik kanë shtruar nevojën e domosdoshme për ndryshime imediate në këtë ligj. Si relator i këtij projektligji po jap

disa konsiderata për disa çështje që lidhen me vlerësimin e anës përmbajtësore, por dhe anës të teknikës legjislative të aktit në fjalë.

Së pari, projektligji i paraqitur përmban rreth 93 nene të cilat ndryshojnë, shtojnë ose shfuqizojnë nene ose pjesë nenesh të ligjit ekzistues. Në pamje të parë, numri i neneve të prekura nga projektligji duket i konsiderueshëm dhe mund të përdoret si argument për propozimin e një ligji tërësisht të ri, megjithatë nga përmbajtja e projektligjit vihet re se çështjet të cilat janë rregulluar tërësisht janë vetëm disa dhe nuk prekin në fakt thelbin e ligjit të Gjykatës Kushtetuese, i cili, përveç çështjeve që lidhen me emërimin, me procedimin disiplinor dhe disa kompetenca, çështje këto të rirregulluara, si rrjedhim i ndryshimeve kushtetuese, nuk paraqet ndonjë ndryshim rrënjësor në përmbajtje të tij ose natyrën e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese si organ kushtetues.

Gjithashtu, ligji i Gjykatës Kushtetuese ka tashmë një traditë prej 16 vjetësh dhe nuk është bërë pengesë për mirëfunksionimin e saj. Përmirësimet ligjore që sjell ky projektligj kanë si synim bërjen e Gjykatës Kushtetuese më efektive dhe përmirësimin e performancës kushtetuese të saj si gjykatë që të zgjidhë efektivisht konfliktet kushtetuese, por edhe rivendos në vend të drejtat themelore të shtetasve në përputhje me rekomandimet e mësipërme.

Nga pikëpamja e përmbajtjes së tij projektligji duhet parë në 3 aspekte kryesore.

Aspekti i parë është procesi i emërimit të zgjedhjes së gjyqtarëve, mandatit të tyre dhe procedimit disiplinor. Kjo pjesë mendoj se është një nga ndryshimet më të rëndësishme të këtij projektligji i cili sjell dispozita të hartuara në nivel të lartë profesional duke parashikuar me detaje të mjaftueshme nene që lidhen me procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat i kanë munguar thuajse tërësisht kuadrit aktual ligjor. Përveç vjetërsisë 15-vjeçare në punë, gjë e cila për mendimin tim nuk është mjaftueshmërisht e lartë për këtë nivel gjyqtarësh, projektligji parashikon detaje të tjera të lidhura me profesionalizmin dhe integritetin moral të kandidatëve, gjë që do të çojë në përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë për këtë gjykatë.

Më tej projektligji parashikon jo vetëm kriteret profesionale, por dhe kushtet e mosplotësimin e të cilave pa sjellë skualifikimin e kandidatit, megjithëse ai mund të

përmbushë kriteret profesionale. Kjo është një vlerë e shtuar që garanton cilësinë e gjyqtarëve të lartë.

Në nenet 7/b, 7/c dhe 7/ç parashikohen procedurat e emërimit dhe të zgjedhjes nga Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë. Ajo që bie në sy është se në fazën e përzgjedhjes dhe të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk është mbajtur i njëjti standard, për sa i takon për shembull seancave dëgjimore të zhvilluara nga Kuvendi, ndërkohë që seanca të tilla nuk parashikohen për dy organet e tjera, megjithëse janë të zgjedhura indirekt nga Kuvendi, ose nga struktura të tjera.

Gjithashtu, në nenin 7/ç, në paragrafin 4, parashikohet që nëse Gjykata e Lartë nuk zgjedh gjyqtarin në votimin e parë mund të zhvillojë një votim të dytë midis dy kandidatëve që kanë fituar më shumë vota. Ndërkohë për procesin që zhvillohet para Kuvendit nuk është parashikuar një mundësi e tillë. Mendoj se do të ishte me vend të parashikohej i njëjti standard nisur nga fakti se Kuvendi është i vetmi organ i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli dhe votimi prej tij kërkon një vullnet më të madh politik sesa për organet e tjera.

Projektligji parashikon dhe një risi, procedimin disiplinor, koncept i cili është futur në të gjitha nivelet e gjyqësorit përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese. E veçanta këtu është se procedimi zhvillohet nga vetë Gjykata Kushtetuese. Në projektligj, neni 92 që parashikon nenin 86 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese parashikohet se procedimi disiplinor për periudhën 9-vjeçare të funksionimit të kolegjit të apelimit do të kryhet nga ky i fundit në kuadër të ligjit të posaçëm për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Dëshiroj të sjell në vëmendje të ekspertëve që në atë ligj të parashikohet me detaje edhe kjo procedurë, e cila do të zbatohet për këtë periudhë kalimtare. Projektligji parashikon, gjithashtu, edhe dispozitat lidhur me përfundimin e mandatit dhe papajtueshmërinë sipas amendamenteve kushtetuese. Në ligj vihet re se ka nene që nuk kanë ndonjë përmbajtje më të zgjeruar ose më të detajuar se Kushtetuta. Sugjeroj që dispozitat të cilat nuk parashikojnë detaje shtesë nga parashikimet kushtetuese të mos gjejnë vend sërish në ligjin e Gjykatës Kushtetuese, pasi në thelb e rëndojnë atë në mënyrë të panevojshme.

Aspekti i dytë që rregullon ligji është ai i organizimit të brendshëm të tij. Një nga çështjet që rregullon projektligji është përshtatja e tij me ligjin aktual për shërbimin civil po aq sa ai gjen zbatim në administratën e Gjykatës Kushtetuese.

Një çështje tjetër lidhet me mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së Gjykatës Kushtetuese dhe që projektligji e adreson rishtas është dhe ngritja e njësisë së shërbimit ligjor që do të kryejë funksionet e një bërthame që ofron këshillim dhe ndihmë ligjore në procesin vendimmarrës, i cili deri tani në fakt është krijuar nga këshilltarët ligjorë, statusi dhe roli i të cilëve ka qenë i parregulluar më parë aktet ligjore ose nënligjore. Sipas nenit 14/a të këtij projektligji këshilltarët ligjorë tashmë do të jenë gjyqtarë ose prokurorë duke siguruar uniformizimin të të gjithë atyre që ushtrojnë funksione gjyqësore brenda sistemit të drejtësisë. E vlerësoj pozitivisht këtë parashikim, që ofron jo vetëm një garanci për këshilltarët ligjorë, si një strukturë tepër e rëndësishme e Gjykatës Kushtetuese, por siguron qëndrueshmëri dhe cilësi në vendimmarrjen e saj e cila për shkak të përtëritjes së pjesshme të përbërjes së saj e ka të domosdoshme të ruajë stabilitetin dhe profesionalizmin nëpërmjet këshilltarëve ligjorë.

Pjesa e tretë e ndryshimeve që sjell projektligji lidhet me procedurat e gjykimit, subjektet kërkuese, afatet e gjykimit, si dhe dhënien e vendimit dhe zbatimin e tij. Kështu vihet re se janë propozuar ndryshime që lidhen me kritere të detajuara që duhet të plotësojë një kërkesë që paraqitet para Gjykatës Kushtetuese me qëllim zhvillimin e një procesi cilësor vendimmarrës, por dhe të qenies më efikase të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, sipas propozimeve rezulton se përfaqësimi para Gjykatës Kushtetuese do të jetë më cilësor dhe do të bëhet i mundur parandalimi i rritjes së pajustificuar të ngarkesës për sa u takon kërkesave që nuk mund të pranohen për shqyrtim, pasi janë gjykuar më parë ose janë në kundërshtim me natyrën e gjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Një nga problemet që ka sot vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese është shpallja e vendimit të arsyetuar brenda një afati të arsyeshëm. Këtë problem duket se e eliminon ky projektligj, i cili ka parashikuar rregulla më efikase, lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, nga momenti që çështja kalon për gjykim deri në shpalljen e vendimit. Është parashikuar që seanca publike të zhvillohet vetëm pasi çështja të jetë e përgatitur mirë nga relatori dhe vendimi të merret mbi bazën e projektvendimit, i cili pas votimit mbi të mund të shpallet brenda disa ditësh. Në këtë

mënyrë shmanget publikimi vetëm i dispozitivit të vendimit dhe dalja e arsytimit të plotë pas disa javësh ose muajsh. Janë rishikuar edhe afatet ligjore brenda të cilave mund të vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese. Konkretisht, për kërkesat individuale është propozuar afati 4-mujor, nga 3 vjet që ishte afati për kundërshtimin e akteve normative, është bërë 2 vjet.

Po kështu janë detajuar me procedurë afate dhe subjekte kërkuese disa procedura gjykimore që kanë qenë të parregulluara fare ose të rregulluara jo mjaftueshëm nga ligji ekzistues të tilla si: zgjedhshmëria e deputetëve, shkarkimi i Presidentit të Republikës, shqyrtimi i papajtueshmërisë së deputetëve i referendumit etj.

Një vend të veçantë zë dhe ankimimi individual kushtetues, i cili mungon tërësisht në ligjin ekzistues, megjithëse zë pjesën më të madhe të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kre është shtuar gjithashtu dhe shqyrtimi i detyrimeve që rrjedhin nga gjykatat ndërkombëtare vendimet e të cilat sjellin detyrime për Gjykatën Kushtetuese.

Së fundi, projektligji sjell dhe përmirësime për sa i takon parashikimit të efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të ekzekutimit të tyre, duke qenë se nuk mund të ketë mjete të tjera efikase për zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Përveç vullnetit të organeve shtetërore ose jopublike për zbatimin e tyre është sugjeruar që mosrespektimi i vendimeve të saj, në rast se është i qëllimshëm, të mund të çojë deri në përgjegjësi penale sipas kërkesave të ligjit.

Për sa i takon hartimit të projektligjit, nga ana e teknikës legislative, mendoj se ai i plotëson të gjitha kërkesat që duhet të respektojë hartimi i një ligji. Riorganizimi i neneve sipas afërsisë dhe fushës së tyre rregulluese, duke i shkrirë ose plotësuar ato me njëra-tjetrën, e bën ligjin ekzistues më të orientueshëm, më të qartë dhe më praktikë për të gjithë përdoruesit e tij. Gjuha ligjore dhe terminologjia e përdorur është e qartë dhe nuk krijon përplasje ose konfuzion në konceptet juridike. Ajo harmonizohet mjaft mirë me pjesën ekzistuese dhe të paprekur të ligjit të Gjykatës Kushtetuese.

Vlerësoj se ky projektligj do të sjellë rritje të efikasitetit dhe efijencës në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, si dhe do të rrisë edhe më shumë besimin e publikut te ky organ kushtetues.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka vlerësime apo komente të tjera, meqë kemi përmbushur dhe pjesën e pyetje-përgjigjeve? Nuk ka.

A jeni dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. A ka vërejtje, sugjerime për këtë nen? Dakord.

Neni 2. Po, zoti Sadushi.

**Sokol Sadushi** – Zoti kryetar,

Për shkak të një ndryshimi të vogël që ka ndodhur në draftin kushtetues, në nenin 124 është hequr fraza “është autoriteti më i lartë”. Dhe jemi të detyruar që t’ua bëjmë me dije, që, pavarësisht se mund të kemi opinione të ndryshme për draftin kushtetues, kemi rënë dakord që Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Dhe në ligj duhet të gjejë reflektim ai formulim.

**Fatmir Xhafaj** – A ka sugjerime të tjera? Jeni dakord me ndryshimin e bërë për të reflektuar.?

Neni 4. A ka pyetje, vërejtje, sugjerime? Gjykata Kushtetuese thotë në tekst që administron në mënyrë të pavarur buxhetin e saj, të cilin e harton dhe ia paraqet për miratim Kuvendit të Shqipërisë. Pyetja ime është...

Më falni, është neni 3. Kalova te neni 4 pa dashje.

Te neni 3, pas fjalëve “flamuri kombëtar” shtohet fjala “stema”.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Kam një pyetje. Aktualisht Gjykata Kushtetuese ka stemë apo ka stemën e Republikës së Shqipërisë? Apo ka stemë specifike?

**Sokol Sadushi** – Stema e Republikës është për të gjitha institucionet, por Gjykata Kushtetuese ka një logo të saj. Që e quajmë stemë e cila pak a shumë simbolizon zhgabën, por në një formë ndryshe që tregon dhe kolonat e drejtësisë. Ka stemë të saj.

**Fatmir Xhafaj** -A jeni dakord me nenin 3? Dakord.

Po e ripërsëris pyetjen për nenin 4. Meqenëse flitet për buxhetin dhe natyrisht këtu qeveria ka pjesën kyçe të procesit të hartimit të diskutimit dhe pastaj të paraqitjes në

Kuvend për miratim, cili është raporti që krijohet ndërmjet gjykatës dhe qeverisë? Dakord mund të jetë e pavarur, por një raport në kuptimin që të dijë sa është parashikuar, cilat janë mundësitë? A ka mundësi më shumë, a ka mundësi më pak është Kuvendi pastaj që vendos, nuk diskutohet. Ose në versionin që ndoshta qeveria e sjell, gjykata paraqet një alternativë dhe Kuvendi vendos.

**Sokol Sadushi** -Ju keni të drejtë për mënyrën se si është formuluar. Në fakt ne këtu nuk kemi bërë ndonjë ndryshim të madh nga legjislacioni ekzistues, nga neni 6 që ka ligji “Për Gjykatën Kushtetuese”. Natyrisht edhe formulimi aktual është pothuajse ky, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka për qëllim të përjashtojë qeverinë, sepse dihet se si është procedura për miratimin e buxhetit. Ndoshta për ta bërë më të qartë, mund të vendoset diçka, por besoj se e nënkupton që nuk përjashtohet qeveria nga faza e hartimit të projektbuxhetit, sepse është e kuptueshme sesi kalon buxheti.

**Fatmir Xhafaj** – Me mënyrën sesi e keni paraqitur ju këtu jam dakord.

“E harton dhe e paraqit për miratim”. Pra, e harton vetë dhe e paraqet po vetë. Ky është koncepti.

Unë jam dakord për pavarësinë e gjykatës, prandaj është një organ kushtetues që e ka raportin me ligjvënësin.

**Sokol Sadushi** - Më falni zoti kryetar!

Të paktën nga përvoja ime, kur është miratuar ligji në vitin 2000 është pasur në vëmendje sesi janë të gjitha ligjet ekzistuese për gjykatat Kushtetuese. Në fakt, ky është formulimi. Ka edhe një arsye që përgjithësisht pranohet se nëse Gjykata Kushtetuese harton një projektbuxhet, qeveria nuk duhet të ndikojë fort mbi të, sepse krijon një lloj varësie edhe për shkak të një pavarësie buxhetore, por jo duke e shmangur qeverinë, por duke i dhënë një lloj autonomie gjykatës, është ky formulim.

Në këtë kuptim, ndoshta Gjykata Kushtetuese e ka këtë lloj specifike për vetë pozicionin që ka, por ju mund ta vlerësoni vetë se nuk ka për qëllim për të përjashtuar qeverinë, por ka një nëntekst që qeveria të mos ndikojë fort në pakësimin apo në zvogëlimin e buxhetit të Gjykatës Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** - Po, prandaj është Kuvendi.



**Petrit Vasili** - Pyetja është shumë e thjeshtë. Ne e dimë dhe nuk lëvizim dot nga kjo kornizë që paraqitëse e projektbuxhetit të shtetit është qeveria. Ne miratojmë ligjin integral të buxhetit, ku një nga institucionet është edhe Gjykata Kushtetuese. Qeveria sado të jetë, nëse vendi është në krizë, edhe Gjykata Kushtetuese do të marrë më pak, po jetë në gjendje të mirë, do të marrë më shumë sipas nevojave, por unë mendoj se kjo linjë duhet të jetë shumë e qartë. Ajo i paraqet si çdo institucion tjetër, por në këtë çështje nuk mund të lëvizim nga standardi, pasi ligji “Për buxhetin” është një ligj integral dhe një dispozitë e tillë nuk duhet të jetë e paqartë. Propozuesja në qeveri është Gjykata Kushtetuese, por qeveria paraqet projektbuxhetin e kësaj gjykate së bashku me të gjitha institucionet e tjera. Pastaj se cili është procesi i negocimit të gjykatës me qeverinë për nevoja më të shtuara apo për buxhete të tjera që lindin, kjo është normale, është një proces që e bën çdo institucion, por për mua kjo gjë duhet të jetë shumë e qartë, sepse krijimi i idesë sikur Gjykata Kushtetuese e paraqet vetë buxhetin dhe e miraton në Kuvend, kjo nuk mund të ndodhë. Kjo dispozitë nuk është thelbësore, por e paraqitur qartë na vë në kushtet e korrektesës së ligjit “Për buxhetin”.

**Fatmir Xhafaj** – A mund të ketë vend për të bërë një reflektim deri në votimin në tërësi? Ta lëmë të hapur, ndoshta për ta diskutuar edhe me Ministrinë e Financave për një riformulim, që të jetë ky raport. Gjykata Kushtetuese është në të drejtën e saj, mund të paraqesë, administrimin pa diskutim, nuk shtrohet çështja për të prekur administrimin. Te procesi i hartimit duhet të ketë një marrëdhënie ndërmjet gjykatës dhe qeverisë. Pastaj është Kuvendi ai që vendos, pa diskutim. Dispozita është e qartë te pjesa e administrimit dhe e miratimit, te pjesa e hartimit ka nevojë për një marrëdhënie, qoftë edhe komunikimi me qeverinë.

“Merr pjesë në hartimin ose në konsultimin”. Dakord. Ta lëmë të hapur?

**Sokol Sadushi** - Më fal!

Është e vërtetë që në pamje të parë krijon një përshtypje sikur Gjykata Kushtetuese bën një projektbuxhet pa marrë parasysh atë që thotë qeveria, por Kuvendi prandaj është për të ndaluar nëse gjykata abuzon me të drejtën e saj. Qëllimi i këtyre dispozitave është i tillë, është në të gjitha ligjet e gjykatave Kushtetuese, që t’i japë një lloj fizionomie të pavarur gjykatës, jo për të bërë çfarë të dojë, por të paktën për të mos e prekur lehtësisht buxhetin e saj.

Unë do të sugjeroja, nëse mund të shtohet diçka, rregullat që lidhen me miratimin e projektbuxhetit. Ajo e zgjidh çështjen, por edhe kështu në opinionin tonë...

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, shikojeni këtë. Po e lëmë të hapur.

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Mos u mërzisni për insistimin. Dispozita është shkruar në këtë mënyrë që Gjykata Kushtetuese administron në mënyrë të pavarur buxhetin. Kjo është e vërtetë, të cilin e harton dhe e paraqet për miratim në Kuvend, kjo nuk mund të ndodhë dhe kjo është një gjë që edhe sikur ta lëmë këtu, edhe ai që nuk ka kualitet të madh në këto punë, do ta kontestojë, pasi ajo nuk i paraqet për miratim Kuvendit buxhetin e saj. Kjo është e prerë. Çdo lloj paraje publike paraqitet në Kuvend nga qeveria e Shqipërisë. Ajo harton dhe i paraqet qeverisë për t'u bërë pjesë integrale e buxhetit të shtetit, buxhetin e saj, kjo është fare e vërtetë, por që ajo ia paraqet Kuvendit, ky mekanizëm nuk ekziston. Gjykata Kushtetuese nuk mund të vijë me një draftbuxhet dhe ne në sallë ta votojmë këtë buxhet, sepse nuk e ka këtë mundësi. Ligjet e administrimit të buxhetit të shtetit janë shumë të qarta në këtë pikë dhe ne nuk e kemi ndryshuar këtë praktikë. Edhe institucionet e tjera të pavarura kushtetuese mund të kishin një dëshirë të tillë, por kjo nuk mund të ndodhë, sepse qeveria përcakton tavanet, shikon mundësitë e saj ekonomike, ne mund të jemi në ditë të vështira, mund të jemi në ditë të mira, prandaj mundësia që Gjykata ia paraqet për miratim Kuvendit, nuk ekziston, nuk ia paraqet dot Kuvendit. Propozuesja e projektbuxhetit në bazë të ligjit integral të buxhetit, të cilit do t'i vijë radha ta kalojmë në nëntor apo në dhjetor, ku një nga institucionet është Gjykata Kushtetuese. Çështja e ndjeshmërisë, e paprekshmërisë, të negociimit që bën me qeverinë është një proces normal, i zakonshëm, mund të ketë edhe kërkesa ekstra, në proces e sipër të Gjykatës Kushtetuese, por mund të ketë edhe pamundësi objektive nga qeveria që t'ia përmbushur të gjitha, por propozuesi në Kuvendin e Shqipërisë i gjërave që mbulojnë buxhetin e shtetit është vetëm qeveria shqiptare.

**Fatmir Xhafaj** – Besoj se biem dakord se ka nevojë për ta riparë këtë formulim.

Vazhdojmë me nenin 5. Kreu II, që ndryshon titullin “Përbërja dhe mandati i Gjykatës Kushtetuese”. Neni 7, ndryshohet si vijon. Jeni dakord? Ky është marrë siç

është në projektin kushtetues. Konsiderohet e mbyllur kjo, sepse vjen nga projekti kushtetues.

Neni 6. Pas nenit 7 shtohet neni 7, "a" me përmbajtjen si vijon. Neni 7, "a".  
"Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarëve, të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese".

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam tri pyetje dhe kërkoj sqarim. E para lidhet me germën "dh" të paragrafit të parë, ku thuhet: "Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe të verifikimin të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". Pyetja ka të bëjë me "familjarët e tij". Në konceptin tim, mënyra se si është përcaktuar "familjarët e tij" është jo e qartë, është shumë e gjerë, mund të jetë familja bërthamë, mund të jetë më e gjerë. Prandaj dua të di: keni pasur parasysh përkufizimin që i jep ligji "Për Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Deklarimit të Pasurive" konceptin e familjarëve, sepse nuk përdoret fjala "familjarët e tij" në ligj? Nëse ju keni menduar ta zgjeroni, është tjetër punë, por duhet të saktësohet se cilët janë familjarët.

**Fatmir Xhafaj** - Jo, është sipas ligjit...

**Vasilika Hysi** - Pra, duhet të përcaktohet.

E dyta, në paragrafin 2, germa "c", ju thoni: "Kandidati të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik dhe moral". Kush e bën vlerësimin për një kandidat që konkurren për herë të parë? Fjalën e keni për vetingun, apo kur mbaron procesi i vetingut për vlerësim?

E treta, në paragrafin e tretë të këtij neni, germa "dh", ju thoni: "Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë edhe të informacionit të marrë nga institucionet e tjera publike".

**Fatmir Xhafaj** - Ke edhe sot.

**Vasilika Hysi** - Mënyra sesi është formuluar është e qartë për informacionet e marra lidhur me cilin: me integritetin, me pasurinë apo për çdo lloj tjetër informacioni?

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Anastasi.

**Aurela Anastasi** – Faleminderit!

Për pyetjen e parë, germa “dh”, pika 1, ne do të thoshim që duhet t'i referohemi ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, atë çfarë bën ky ligj, atë do të zbatojmë në këtë rast.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, mund të vendosim referencë, por edhe sikur të mos e vëmë referencën sikurse e kemi paraqitur, nuk ka mundësi tjetër. Do të ecim me ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”. Referohet ai, referohemi edhe ne, përcakton ai, përcaktohem edhe ne.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Sadushi.

**Sokol Sadushi** - Lidhur me pyetjen e dytë dhe të tretë unë do të jepja këtë koment. Për sa i përket pikës 2, germa “c”: “Të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik dhe moral”, më tepër këtu është e lidhur me të gjithë gjyqtarët kushtetues, me të gjitha prurjet që vijnë, por aq sa është e mundur kjo pikë do të vlejë për ata që vijnë nga gjyqësori në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse ata kanë një vlerësim të aftësive profesionale, ashtu siç kanë edhe vlerësimin e integritetit etik dhe moral, nuk e përjashton dot. Ndërkohë, është gjithmonë e hapur që të interpretohet edhe me verifikimin apo me rivlerësimin që i bëhet për shkak të vetingut, për aq sa është e mundur për sa i përket integritetit etik dhe moral. Pra, kjo pikë shkon në funksion edhe të germës “dh”, por më tepër është vënë për shkak të atyre që vijnë nga gjyqësori që “aftësinë profesionale” e kanë të domosdoshme si kriter vlerësimi.

Lidhur me germën “dh” të pikës 3, kjo është e hapur. Ne kemi ruajtur pak a shumë edhe formulimin aktual që ka ligji “Për Gjykatën e Lartë” lidhur me gjyqtarët, me kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, është e hapur për çfarëdo lloj informacioni që mund të marrë në këtë rast organi i emërtesës lidhur me kandidaturën përkatëse. Nuk përjashtohet mundësia që Presidenti në këtë rast që është një ndër personat, një ndër organet që e emëron të marrë informacion nga të gjithë institucionet që ai mendon se i vlen për këtë emërim, ashtu si edhe Kuvendi dhe Gjykata e Lartë. Pra, është e hapur në vlerësimin e emërtesës për të marrë informacion nga kushdo.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Unë e kam rimarrë këtë argument që do të marr tani. Nuk besoj se është thelbësor, por mendoj se duhet ta pastrojmë sa të mundemi nga përcaktimet, të cilat janë evazive.

Germa “b”, e pikës 2: “Të ketë një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtat e njeriut apo sfera të tjera të së drejtës”, besoj se duhet të jemi të kursyer nga përcaktorët: “i spikatur”, “i shquar” e të tjera, pasi pasja e një veprimtarie në fushën e të drejtës kushtetuese është e mjaftueshme. Çështja e përcaktorit “të spikatur” është evazive dhe shumë subjektive, pasi te një pjesë e këtyre në fushën e të drejtës kushtetuese, për shembull ka të bëjë edhe veprimtaria, publikimi apo kontributet e tjera në fushat që janë edhe të karakterit shkencor po të doni, në të cilat është i vlefshëm. Sa i vlefshëm është këtë nuk e përcaktojnë këto lloj përcaktorësh. Ka kritere shumë të qarta, niveli ku botohet, ku ofrohet, por ideja e të qenit të spikatur apo jo, për mua është një kriter, i cili në momente të caktuara të një barazie shumë të fortë të kandidatëve, është lehtësisht i shpërdorueshëm: edhe një veprimtari imja është pak më e spikatur se sa e dikujt tjetër. Unë mendoj që pasja e një veprimtarie, pa spikatur, në fushën e të drejtës kushtetuese dhe të drejtave të njeriut dhe sferave të së drejtës, do të thotë që kandidati ka shprehur interes dhe ka pasur një veprimtari të caktuar në të. I spikatur apo jo, ne futemi në këtë fushë dhe atëherë ka kritere të tjera që e rregullojnë ndryshe këtë punë. Nëse ka botime, cili është niveli i tyre dhe ku, që përcaktojnë dhe rankimin e peshës së botimeve. Kjo dihet, kushdo që merret me veprimtari shkencore. Në fushën e të drejtëve të njeriut është shumë evazive. Një aksion i dikujt mund të duket shumë i shquar, shumë i spikatur, por në këndvështrimet e të tjerëve mund të jetë një veprimtari e kontestuar. Ne çfarë interesi kemi? Kandidati ynë të ketë veprimtari në këtë fushë, pra të jetë i familjarizuar, të ketë dhënë kontribute, por “të spikatura”, “të shquara” apo “të pashquara”, nuk janë një koncept ligjor dhe ne po bëjmë një ligj. Unë do të propozoja të mbetemi që ta ketë veprimtarinë, po shumë mirë, jam shumë dakord, ky ka interes, kontribuon në këto drejtime, në këto fusha të mëdha që e afrojnë edhe me çështjet e Gjykatës Kushtetuese, por i spikatur apo jo, do të dalë dhe do të thotë: “Veprimtari ime është më e spikatur sesa e Fatmirit”, po marr emrat e njëri-tjetrit për të mos krijuar keqkuptim, këtë e spastrojmë, jemi shumë të qetë dhe themi: ose ke qenë i

huaj ndaj kësaj fushe, nuk ke pasur asgjë dhe ky nuk është një plus më shumë, por është një minus për ty si kandidat.

Ky është sugjerimi ynë.

**Fatmir Xhafaj-** Faleminderit!

Edhe unë kam të njëjtën ngarkesë për fjalën “të spikatur”, edhe për shkak se ka marrë nga pikëpamja formale një konotacion negativ në gjithë këto vite kur kemi thënë: jurist “i shquar”, “i spikatur” e të tjera.

Sikur të qëndronim vetëm këtu, të paktën në këtë rishikim do të duhet ta zbusnim apo t’i gjenim një zgjidhje tjetër. Plus unë në përgjithësi të këto kritere jam për atë që sa më pak evazivitet do të ishte shumë mirë. Nëse kemi mundësi të shkojmë drejt kritereve më objektive, të matshme për opinionin publik për konkurrentët dhe për organet e emërtesës, do të ishte një gjë shumë e mirë. Përsëri vazhdoj të insistoj nëse ka edhe pak kohë, deri në momentin që do të shkojmë te votimi final, duhet ta rishikojmë në tërësi që t’i forcojmë këto kritere, nëse ka edhe ndonjë gjë akoma më të avantazhuar. Për shembull, unë do të pranoja të ketë një veprimtari dhe kontribute konkrete. Do të thotë që ke kontribut dhe pastaj është e drejtë ajo që thotë zoti Vasili. Për shembull, në fushën e të drejtave të njeriut mund të ketë vetëm një aksion qytetar, por ai i ka vlejtur shoqërisë shumë më tepër se një njeri që është veprimtar në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo është një çështje që nuk e mat dot nëse e lë shumë evazive.

Të mbarojmë me këtë temë që ka qenë dhe është edhe sot më shumë sensitive.

Urdhëroni, zoti Sadushi!

**Sokol Sadushi** – Ju keni shumë të drejtë në argumentet që jepni, sepse me të vërtetë një terminologji e tillë mund të ketë krijuar problematikë ndër vite, në lidhje me juristin e shquar. Natyrisht, shprehja “veprimtari e spikatur” duket sikur shkon në të njëjtën linjë, por unë do të bëja vetëm një sqarim të vogël, ndoshta për të hequr pak shqetësimin ndoshta të përligjur, që keni ju. Këshilli i emërimeve në drejtësi do të ketë një rregullore të veçantë që do të përcaktojë saktësisht të gjitha elementet ndoshta edhe me një pikëzim (të paktën pretendojmë të jetë e tillë), ku do të evidentohet saktësisht sesi dallon njëri nga tjetri. Duhet patjetër të jetë një epitet mbas fjalës “veprimtari”. Nëse fjala “e spikatur” nuk tingëllon mirë, duhet patjetër të jetë diçka, që ta evidentojë nga tjetri. Në vijim pika 3, ka patjetër kritere përgjithësisht objektive. Mendohet që do të

ketë një lloj pikëzimi për secilin prej kriterëve dhe duhet të jetë një evidentim i fjalës i spikatur, i njohur i shquar, të mendojmë për çdo lloj termi, që t'i japim mundësi këshillit të emërimeve në drejtësi, kur të bëjë evidentimin e personave që kanë bërë disa punime shkencore, disa artikuj, disa libra, të dallohet ai që ka bërë një artikull, i cili ka veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut me një artikull, me atë që ka bërë disa punime në fushën e të drejtave të njeriut, që në fakt nuk është një lloj si ai që ka bërë një artikull. Që të bësh diferencën mes atij që ka bërë një artikull dhe atij që ka bërë disa, duhet të jepet një term që këshilli i emërimeve të bëjë një lloj pikëzimi. Në këtë aspekt ne kemi ndjekur formulimin e draftit kushtetues. Është i njëjti formulim që gjendet edhe në nenin 125 të draftit kushtetues: “me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës”. Nuk kemi bërë ndonjë ndryshim nga drafti kushtetues dhe prandaj...

**Fatmir Xhafaj** – Po ta lësh për një moment kështu, pa një nga përcaktorët që kërkonin ju, kjo lidhet me pikën 3, sepse ju thoni që kjo detajohet te pika 3 dhe nuk po humbet ndonjë gjë, praktikisht.

**Sokol Sadushi** - Është e vërtetë që lidhet me pikën 3, por duhet bërë një diferencë.

**Fatmir Xhafaj** – Mjaft që ai ta ketë veprimtarinë dhe pastaj kush e ka të spikatur, të shquar, të dallueshme apo të vlerësueshme, këtë e përmban pika 3.

**Sokol Sadushi** - Është e vërtetë që pika 3 bën diferencën, por insistojmë te një lloj terminologjie që duhet vendosur, sepse i jep mundësinë këshillit të emërimeve nesër, të bëjë diferencën dhe vërtet diferenca do të bëhet mbi bazën e pikës 3, por pika 3 kërkon të ketë diçka edhe te pika 2. Kjo është logjika që kemi ndjekur ne për të diferencuar të gjithë elementet e pikës 3.

**Fatmir Xhafaj** – Bëni një përpjekje për të gjetur një përcaktim!

**Sokol Sadushi** – Po.

**Petrit Vasili** – Sokol, unë dua të them miqësisht një gjë: ne e dimë shumë mirë se veprimtaria shkencore ka disa elemente që janë kokëforta. Ne që jemi marrë me shkencë, e dimë që ka pasur disa njerëz që kanë bërë 3-4 libra, dhe ka pasur edhe njerëz që kanë bërë artikuj, që i kanë ndryshuar gjërat. Sot ka njerëz në botën e shkencës, që njihen për një publikim të vetëm që kanë ndryshuar këndvështrimin e gjërave dhe ka njerëz që kanë shkruar një vëllim me libra, të cilat nuk kanë ndryshuar gjë. Prandaj,

duke mbetur te kriteret më profesionale, duke e kursyer ligjin në këtë pikë, jemi më ekonomikë. Ju e dini që ka debate. Fusha e së drejtës është një gjë, por shkenca nuk është vetëm fusha e së drejtës, por ka edhe fusha të tjera. Po të doni, mund t'ju jap sa të doni shembuj, edhe në fushën tuaj po të doni, që një interpretim i caktuar, një artikull i caktuar ka ndarë një interpretim të madh, ndërkohë ka pasur plot të tjerë që kanë qenë prodhues të mirë, por nuk kanë shënuar diferenca. Ne themi se e çlirojmë nga kjo gjë dhe më pas bëni kriteret ju dhe jemi në rregull, por e çlirojmë nga kriteret e asaj që quhet subjektive. Se do të vijë dikush, një kolegu juaj, që është nga fusha e drejtësisë, i cili do të thotë se me këtë se me këtë interpretim apo me këtë qasje që ka bërë, ka ndryshuar këndvështrimin e një gjëje.

Në mbyllje po jap një shembull: në fushën tonë kemi pasur një doktor të quajtur Nazmi Dibra, i cili ka bërë vetëm një publikim të madh për zbulimin e një shtami salmonele, ndërkohë që kishte kolegë nga tanët, që kishin shkruar mbi 7 libra, të cilët nuk ishin në analet asgjëkund. Dua të them që në këtë pikë bashkohem plotësisht me atë që thotë zoti Xhafaj: duke ecur më tutje në kriteret e vlerësimit, në mënyrën si do ta interpretosh është më mirë, sesa t'i fiksojmë këto gjëra, sepse hymë në një qark dhe pastaj secili në punën e vet do të fillojmë të pengojmë njëri-tjetrin.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord besoj.

**Sokol Sadushi** – Sigurisht, dakord do të jemi, nëse e sugjeroni ju, por problemi është që duhet ta heqim fjalën “të spikatur” dhe ta zëvendësojmë me një fjalë tjetër apo do ta lëmë: “veprimtari në fushën e”?

**Fatmir Xhafaj** – Veprimtari në fushën e së drejtës. Të ketë kontribute konkrete në fushën e së drejtës kushtetuese. Kaq.

**Vasilika Hysi** – Unë e kuptoj shqetësimin e kolegut Vasili. Ta lësh të hapur “ka veprimtari” apo ta lësh siç e sugjeruat ju: “ka veprimtari konkrete në fushën e së drejtës”, përsëri nuk tregon që personi e meriton se ka veprimtari. Ka persona që mund të kenë një veprimtari të gjatë dhe mund të kenë edhe botime dhe nuk kanë ndonjë vlerë (jam dakord me këtë), por kontribute konkrete kanë të gjithë. Sa efektive, sa vlerë kanë ato...

Nga ana tjetër, fjala “e spikatur” ka shërbyer një herë, në procesin e vlerësimit të kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese, që të ndërpresim procesin e seancave dëgjimore dhe i kemi kërkuar gjykatës ta interpretojë se çdo të thotë “jurist i shquar”.



Fjalët “i shquar dhe i spikatur” janë superlative dhe nga njëra anë janë edhe subjektive, por nga ana tjetër, ka disa kriterë. Për këtë arsye unë do të doja ta linim të hapur dhe të gjenim sesi e kanë legjislacionet e Gjermanisë dhe të vendeve të tjera, çfarë termash përdorin për përzgjedhjen e kandidatëve. Njëkohësisht, në dijeninë time, edhe institucionet ndërkombëtare kur përzgjedhin kandidaturat si për shembull, Komiteti i Ministrave të KE-së për kandidatët për mekanizmat monitorues apo për gjyqtarët, kanë një terminologji të caktuar. Ndoshta stafi mund të na ndihmojë për ta parë këtë pjesë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zoti Majko!

**Pandeli Majko** – Unë nuk do t’i kundërshtoj parafolësit që nxjerrin problemin e ndryshimit të fjalës “të spikatur” dhe mendoj se ka shumë sens vërejtja e bërë, që ha shumë diskutim se çdo të thotë fjala “të spikatur” nga pikëpamja e interpretimit, por mendoj se duke e marrë nga fusha e inxhinierisë, bëhet fjalë që spikatja nuk ka të bëjë me diferencën të anës profesionale se kush është më i mirë apo kush është më i keq. Ajo ka të bëjë me spikatjen e marrjes me një degë të së drejtës që do të thotë (po e kthej përsëri të inxhinieria): është një inxhinier i spikatur, si inxhinier për motorët reaktivë.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një jurist, i cili është i spikatur, i vlerësuar, është hequr mënjanë, sepse është marrë me fushën e së drejtës kushtetuese. Pra, fjala “spikatje” (të më korrigjojnë specialistët), nuk ka të bëjë me diferencat profesionale të juristëve në rrafshin e përgjithshëm, por identifikon sipas degës apo sipas specialitetit juristin, ashtu si në një degë tjetër mund të vepohet për inxhinierët apo për mjekët. Po themi një mjek që është i spikatur në fushën iks apo ipsilon. Po përpiqem ta lidh edhe me formulimin kushtetues që përmendi zoti Sadushi. Pra, përdorimi i fjalës “spikatje” nuk ka të bëjë me diferencat profesionale midis juristëve, por ka të bëjë me marrjen e juristit në fjalë me të drejtën kushtetuese. Pra, i njihet ky moment i veçantë që është marrë me të drejtën kushtetuese si jurist, ashtu siç mund t’i njihet një juristi tjetër në një rast tjetër, që është marrë me të drejtën penale apo me të drejtën civile etj.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo pikë mbetet për t’u riparë.

Kam edhe diçka të ky nen, në vazhdim të diskutimeve të tjera që u bënë. Në germën “ç” të pikës 1, ju thoni: “Të mos jetë nën procedim penal dhe të mos jetë i dënuar për kryerjen e një veprë penale.” Këtu keni parasysht kundërvajtjen? Nëse dikush

për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor do të privohet nga e drejta për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese për shkak se kur ka qenë 19 apo 20 vjeç, mund të ketë shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, a është kjo cilësi përjashtuese?

**Sokol Sadushi** – Sigurisht, këtë qasje kemi pasur. Nëse do të jesh gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, duhet të jesh i pastër nga këto gjëra. Ndoshta kjo është një zgjidhje e arsyeshme, që nuk ka të bëjë me ndëshkimin e këtyre personave, por ka të bëjë me një lloj privimi që këta persona të mos jenë në kupolën më të lartë të drejtësisë shqiptare. Duke thënë vepra penale, nuk përjashtojmë dot asnjë vepër, nuk kemi të drejtë të themi: vetëm për krimet. Nuk mund të përjashtojmë kundërvajtjet, sepse ka disa kundërvajtje që mund të jenë shumë të rënda pavarësisht se ajo që përmendët ju, është diçka që mund t'i ndodhë kujtdo, por nuk dimë të gjejmë ndonjë mekanizëm tjetër për të përjashtuar këto kandidatura, duke vendosur një term tjetër. Termi “vepër penale” nënkupton edhe kundërvajtjet.

**Fatmir Xhafaj** – Shumë e ashpër është.

**Sokol Sadushi** – Jemi orientuar pak edhe nga ligji për dekriminalizimin, megjithatë kjo është diçka që ...

Ne kemi gjykuar që një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të ketë njolla të tilla, pavarësisht se është rehabilituar dhe pavarësisht se mund ta kryer veprën në një moshë të re.

**Fatmir Xhafaj** – Është maksimumi në një shoqëri...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për shkeljen e rregullave të qarkullimit mund të ndëshkohesh me gjobë. Penalisht je ndëshkuar me gjobë, por është pak e ...

**Sokol Sadushi** – Nëse më lejoni, është një lloj formulimi që do ta gjeni pothuajse në të gjitha ligjet që do të vijnë këtu.

**Fatmir Xhafaj** – S'ka problem, ne po e debatojmë këtu.

**Sokol Sadushi** – Thjesht po eci me argumentin që është një lloj standardi që është vendosur pothuajse në të gjitha ligjet dhe ne e kemi përcjellë këtu. Ajo mbetet për t'u diskutuar nga ju, nëse mund të bëjmë një diferencë.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo nuk ka shumë kuptim për ne dhe kam merak për këtë gjë.

Siç e shikoni, të gjithë nuk po e mbështesin këtë.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi,

Unë e kuptoj që me këto ligje po kërkohet të vendoset një standard shumë i lartë. Tani kam një pyetje praktike: A kemi në realitetin shqiptar gjyqtarë që mund të jenë dënuar për drejtim të automjetit në gjendje të dehur, qoftë kur kanë qenë adoleshentë apo kur kanë qenë studentë? Kjo cilësohet vepër penale me burgim nga Kodi Penal.

E dyta, në dijeninë tuaj, në legjislacionet e tjera për gjykatat kushtetuese apo për gjykatat e larta, a parashikohet një kriter kaq i fortë?

Në dijeninë time, me sa mbaj mend, kur diskutuam ndryshimet kushtetuese për deputetët apo për gjyqtarët, thamë: “Të mos jenë dënuar për një vepër penale me burgim.” Nëse ju mendoni që duhet të jetë kështu, dhe personi duhet të dënohet, pavarësisht parashkrimit të dënimit, qoftë edhe për një kundërvajtje për vepra me rrezikshmëri të pakët shoqërore apo për të cilat publiku nuk ka interes, jam dakord, nuk kam ndonjë kundërshtim, por të mos të vijmë më pas në një situatë ku të thonë: se e bëmë ligjin e dekriminalizimit më të ashpër, se ligji “Severini”.

**Fatmir Xhafaj** – Në vazhdim të kësaj që tha zonja Hysi, kjo nuk është pengesë për t’u bërë deputet, por qenka pengesë për t’u bërë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, sepse për deputetin ka kufizime të tjera, janë më të lehtësuara se ligji i dekriminalizimit që po bëjmë tani.

A mund të gjejmë një formulim, që të kemi një standard edhe për atë që bëhet përfaqësues i popullit, edhe për atë që bëhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, se kjo nuk bën sens.

**Sokol Sadushi** – Zoti kryetar,

Ndoshta është e arsyeshme që standardi për gjyqtarët në përgjithësi dhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në veçanti, të jetë më i lartë sesa për deputetët dhe ne mendojmë se është një zgjidhje e arsyeshme që i përshtatet tërësisht edhe vizionit që ka reforma. Sidoqoftë, ne nuk e kemi parë të formuluar në këtë mënyrë në legjislacionet e vendeve të tjera, sepse nuk mendohet që një gjyqtar i Kushtetueses të ketë qenë dënuar dhe të emërohet si i tillë, ndoshta është e nevojshme që një formulim i tillë të zërë vend.

Në qoftë se për një moment do të mendonim që krimet të ndaheshin nga kundërvajtjet, ju përmendët rregullat e qarkullimit, që konsiderohet një vepër jo e rëndë,

pra e lehtë, ka edhe kundërvajtje të tjera, të cilat vërtet janë kundërvajtje, por kanë një lloj perceptimi negativ. Nëse i ndajmë në krime dhe në kundërvajtje...

**Fatmir Xhafaj** – Ne mund ta lëmë...

**Sokol Sadushi** –...do të na hyjnë në Gjykatën Kushtetuese persona që janë dënuar për kundërvajtje, që, në fakt, mund të jenë të rënda në vizionin e qytetarëve, si, për shembull, plagosja e lehtë. Pra, ka shumë vepra të tjera penale dhe ne nuk kemi gjetur një kriter...

**Fatmir Xhafaj** – Por mund ta lidhni, pak a shumë, me kriteret përjashtuese, që ka ligji për integritetin, të paktën minimalisht ose, siç quhet ndryshe ligji i dekriminalizimit.

**Sokol Sadushi** – Aty është vetëm... Në qoftë se do të vendoset termi “me burgim”, në qoftë se janë dënuar me burgim, nëse do të ndjekim këtë argument, por unë të paktën personalisht, se tani pavarësisht se flas në emër të grupit, mendoj që është një kriter i arsyeshëm për një gjyqtar kushtetues që të mos ketë qenë i dënuar.

Në qoftë se ne paskemi kaq shumë persona të aftë në Shqipëri, që, për fat të keq, qenkan dënuar dhe ndëshkohemi për të sjellë në Gjykatën Kushtetuese njerëz të tillë, atëherë le ta tërheqim këtë dispozitë, por kam përshtypjen se është një dispozitë që më tepër vlen. Sidoqoftë, ngelet në vizionin tuaj, por ne të paktën nuk gjejmë ndonjë zgjidhje tjetër për momentin.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Atëherë, duke e riparë gjithë këtë nen, pra ato dy-tre pika që u lanë, të lutem të kihet edhe kjo gjë në vëmendje për t’u diskutuar edhe me standardet që janë në këtë fushë, me standardet në sensin e modeleve që ofrojnë, por edhe në rastin konkret edhe me standardet që kemi vendosur ne vetë si ligjvënës.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Po, po.

**Vasilika Hysi** – E di? Në kuadër të ligjit të integritetit dhe pastërtisë së figurave ne kemi ndryshim kushtetues. Pra, unë do të doja që ndryshimi kushtetues, te neni 6/1 që kemi bërë, në mos gaboj, a është në përputhje me këto lloj përcaktimesh që ne bëjmë? Të mos ndodhë që brenda Kushtetutës njëri nen e kufizon, por nuk e privon 100%, ndërsa një nen tjetër e privon 100%.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, dakord.

Ka shumë të drejtë zonja Hysi, ndaj shikojeni me formulimin kushtetues kur është bërë ndryshimi përkatës.

Në rregull, neni 6 mbetet i hapur për të bërë ndryshimet dhe për t'i reflektuar para votimit në tërësi.

Neni 7/b "Procedura e emërimit nga Presidenti i Republikës". Kush e do fjalën? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje që mendoj se ka nevojë të qartësohet.

Në paragrafin 3 ju thoni: "Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, brenda dhjetë ditëve harton një listë përfundimtare". Kur thoni: "brenda dhjetë ditëve" nga fillon ky afat, që nga momenti që është bërë shqyrtimi, që nga momenti kur është publikuar apo kur thirret mbledhja? Unë mendoj se kjo duhet saktësuar.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Sadushi.

**Sokol Sadushi** – Në pikën 2 është sqaruar: vjen një moment procedural që kryetari i Këshillit të Emërimeve, brenda pesë ditëve nga dita e publikimit, thërret mbledhjen, dhjetëditëshi është i lidhur me thirrjen e mbledhjes. Pra, në momentin që thirret mbledhja Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të shprehet brenda dhjetë ditëve.

**Fatmir Xhafaj** – Po këtu ka nevojë për një afat ("Presidenti i Republikës i cili ia dërgon atë Këshillit")? A ka një afat, përderisa keni vendosur afat për Kuvendin, afat për Gjykatën e Lartë? Brenda 30-ditëve ose ku e di unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pika 1.

Po.

**Sokol Sadushi** – Është e vërtetë, nuk ka afat të përcaktuar, por ka një afat tjetër, që është i detyrueshëm për t'u zbatuar (neni 13), që është afati maksimal: "Procedura për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të quhet më tepër nga 60 ditë nga përfundimi".

Tani, ne nuk kemi vendosur afat për sa i përket këtij momenti, duke e lënë të hapur, që e gjithë kjo procedurë do të ndodhë në momentin që deklarohet i mbyllur mandati i gjyqtarit kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** – Derisa ke caktuar afat për Kuvendin...

**Sokol Sadushi** – Afati tjetër është 60 ditë, maksimalja.

**Fatmir Xhafaj** – Për Gjykatën e Lartë keni caktuar afat, edhe për Kuvendin po, caktojeni edhe për këtë, që të ketë të njëjtin standard.

**Sokol Sadushi** – Në rregull.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, neni 7 miratohet me ndryshimet.

Neni 7/c “Procedura e zgjedhjes nga Kuvendi”.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje lidhur me afatet dhe e rimarr shqetësimin që ngriti kryetari në mbledhjen e kaluar në diskutimin në parim. A janë realiste këto afate kaq të ngushta që janë vendosur? Pra, ju keni thënë: “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese njofton për vendin vakant Kuvendin. Kuvendi, brenda tridhjetë ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën. Brenda pesë ditëve kryetari i Këshillit të Emërimeve...” Domethënë, çfarë mund të ndodhë atë ditë që ka mbledhje dy anëtarë të Këshillit të Emërimeve janë sëmurë? Ju thoni: “pesë ditë”, pra i digjni hallkat. Si veprohet pastaj?

Pra, këto afate kaq të ngushta, ku mund të jetë brenda e shtuna dhe e diela, sepse pesë ditë unë ta sjell të premtën, po të jem hileqare, ose të enjten në darkë dhe të hënën duhet ta kesh bërë mbledhjen. Pra, duhet të ketë një qartësim: ditë pune, ditë kalendarike, nëse do ta lëmë.

E dyta, a janë kaq realiste? Nuk e di ku i keni bazuar këto afate.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Sokol Sadushi** – Ju keni të drejtë, ndoshta afatet mund të krijojnë një opinion që e bëjnë ndoshta edhe të perealizueshëm në kohë vendimmarrjen, por qëllimi i vendosjes së këtyre afateve është për të disiplinuar punën brenda këtyre organeve, që të rritet më tepër përgjegjshmëria që të shprehen në afat.

Unë do të mendoja që këto janë afate, që, në fakt, nuk mund t’i konsiderojmë si afate prekluzive, përjashtimisht afati që përmenda, që lidhet me zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese jo më vonë se 60 ditë nga përfundimi i mandatit të gjyqtarit ekzistues. Ky është afat i prerë.

Duke menduar se tre muaj përpara mbarimit të mandatit, se e gjithë kjo procedurë bëhet përpara, kryetari i Gjykatës Kushtetuese njofton tre muaj përpara përfundimit të mandatit normal të një gjyqtari, njofton dhe fillojnë të lëvizin afatet. Këshilli i Emërimeve mblidhet pikërisht në këtë periudhë kohore.

E gjithë periudha e zgjidhjes së gjyqtarëve kushtetues shkon maksimalisht deri në pesë muaj (tre muaj përpara mbarimit të mandatit dhe dy muaj pas përfundimit të mandatit janë pesë muaj). Afatet që ne kemi vendosur janë më tepër për të disiplinuar organet, që të veprojnë sa më shpejt të jetë e mundur në kohë, por jo se krijojnë pasoja në qoftë se nuk veprojnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Të mos kapemi me...

**Vasilika Hysi** – Kjo është çështje që do të dalë në praktikë.

Kam një pyetje. Në paragrafin e parë ju thoni: “Pranë Kuvendit paraqiten aplikimet e kandidatëve”. Sa ditë do ta lërë Kuvendi njoftimin zyrtar në internet? Do ta lërë 30 ditë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Atëherë, shikoni çfarë thuhet në paragrafin e dytë: “Kuvendi brenda tridhjetë ditëve, nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën”. Jo, pas mbarimit të tridhjetëditëshi, që ka lënë njoftimin në faqen e internetit, pastaj e shpall listën, sepse deri në tridhjetë ditë ai pret aplikime! Nuk mund ta shpallë aplikimin brenda tridhjetë ditëve, por do ta shpallë në ditën e 31-të ose të 35-të, pra duhet rregulluar shprehja.

**Fatmir Xhafaj** – Brenda tridhjetë ditëve është.

**Vasilika Hysi** – Brenda tridhjetë ditëve është njoftimi që pret aplikime.

**Fatmir Xhafaj** – “Publikon listën”, thotë.

**Vasilika Hysi** – Por nuk mund të jetë brenda tridhjetë ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Momenti i hapjes së procedurës është data e sotme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo, e ngatërro!

**Vasilika Hysi** – Kuvendi lë tridhjetë ditë. Pas tridhjetë ditëve mbyllet marrja e aplikimeve dhe më pas Kuvendi, pra mund t'i lëmë tre a pesë ditë ose dhjetë ditë, publikon listën e kandidatëve.

**Sokol Sadushi** – Për ta sqaruar, në pikën 1 shpjegohen hapat proceduralë: “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese njofton...”, në radhë të parë, “...Kuvendin”.

Kuvendi, brenda shtatë ditëve bën shpalljen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Me të bërë shpalljen, fillon afati treditör për marrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Normalisht, ditën e fundit të tridhjetëditëshit, se nuk mund të shpallet më përpara, pasi mund të paraqitet edhe ditën e fundit dikush.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ka tjetër?

**Ulsi Manja** – Shtatëditëshi përfshihet tek tridhjetëditëshi, pra nuk shkon në total 37 ditë, nga momenti pas njoftimit. Brenda këtij tridhjetëditëshi është edhe afati i njoftimit?

**Fatmir Xhafaj** – Dakord? Dakord me nenin 8.

Neni 9, pra shtohet neni 7/ç, me këtë titull “Proçedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po.

**Vasilika Hysi** – Ndoshta unë e kam kuptuar gabim, por ç’lidhje ka në ligjin e Gjykatës Kushtetuese proçedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë? Këtu flitet për Gjykatën e Lartë. Është lapsus, apo...?

**Sokol Sadushi** – Jo, nuk është lapsus, por Gjykata e Lartë është organi emërtesë, që do të zgjedhë tre gjyqtarë kushtetues. Prandaj do të flitet në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese” për mënyrën sesi mbliidhet Gjykata e Lartë për të zgjedhur tre gjyqtarë kushtetues.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*



Jo, do të rregullohet në këtë ligj, pasi bëhet fjalë për anëtarët në Gjykatën Kushtetuese që zgjidhen nga organi emërtesë. Siç është thënë për Kuvendin, siç është thënë për Presidentin, është thënë edhe për Gjykatën e Lartë. Janë tre organet emërtesë që zgjedhin tre gjyqtarë, prandaj zë vend.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, unë do të sugjeroja që titulli i nenit të saktësohet: “Proçedura e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata e Lartë”...

**Sokol Sadushi** – Më falni, por...!

**Vasilika Hysi** – Sepse kur thua: “Proçedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë”, nuk është e qartë proçedura e zgjedhjes, flitet pikërisht për të zgjedhur treshen që është në Gjykatën Kushtetuese, kështu siç e saktësuat ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Petrit Vasili** – Përderisa Gjykata e Lartë ka një ligj të saj...!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është një nga punët që Gjykata e Lartë bën.

*(Diskutime në sallë.)*

Zonja Hysi, më ndiqni pak?

Kjo është një nga punët që Gjykata e Lartë bën. Pse të mos përshkruhet atje edhe kjo punë e Gjykatës së Lartë?

Për sa i takon zgjedhjes së gjyqtarëve nga Gjykata e Lartë, i referohet ligjit “Për Gjykatën e Lartë”. Është më korrekte. Në mënyrë integrale ligji i Gjykatës së Lartë ka të gjitha detyrat që ka brenda Gjykata e Lartë, ku ka për detyrë të zgjedhë edhe gjykatësit, apo jo, Fatmir?

**Fatmir Xhafaj** – Jo, duhet ta përcaktojë ky ligj, pasi nuk...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Atje do ta ketë ai në ligjin e tij, por këtu e ka të detyrueshme...

**Petrit Vasili** – Po ligji i Gjykatës së Lartë do të shkruhet prapë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ia ke referuar ligjit të Gjykatës...

**Fatmir Xhafaj** – Do ta ketë si detyrë, por proçedura e të gjithë zgjedhjes është këtu.

**Petrit Vasili** – Dakord...

**Fatmir Xhafaj** – Po?

**Sokol Sadushi** – Për të sqaruar këtë konfondim, që mund të krijohet në pamjen e parë kur lexon dispozitat, kreu titullohet “Përbërja dhe mandati i Gjykatës Kushtetuese”, (është kre i veçantë) dhe brenda këtij kreu janë këto nene. Në fakt, kreu fillon me procedurën e emërimit nga Presidenti i Republikës (dhe është e kuptueshme që bëhet fjalë për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese), vazhdon me procedurën e zgjedhjes nga Kuvendi dhe me procedurën e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë.

Në këtë aspekt ka kuptim kjo mënyrë e të shkruarit të dispozitave.

**Aurela Anastasi** – Duhet parë në vijimësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Unë kam një pyetje. Ju thoni: “Bashkë me listën edhe dokumentacioni shoqërues për çdo kandidat”, pra ju thoni që në rastin e...

Te pika 2, Këshilli i Emërimeve çon një listë të rasti i Gjykatës së Lartë, kurse në rastin e Kuvendit dhe të Presidentit çon një listë me tre emra. Pse e keni bërë këtë diferencim: për këta nuk lini treshin, kurse këtu lini të gjithë listën, apo se janë brenda komunitetit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pse jo këtu tre emra, apo...?

**Sokol Sadushi** – ..të drejtë ndoshta, sepse si rrjedhojë e opinionit të fundit të Komisionit të Venecias, është bërë një vërejtje që Këshilli i Emërimeve duhet të futet edhe te Gjykata e Lartë. Ndoshta është një lloj lapsusi nga ana jonë dhe është futur, ndoshta nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë ideja që thoni ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Por ne...

**Fatmir Xhafaj** – I njëjti standard do të jetë: tre atje, tre atje.

**Sokol Sadushi** – Ne kemi të njëjtin qëndrim që Këshilli i Emërimeve...

**Fatmir Xhafaj** – Ata do të zgjidhen nga treshja.

**Sokol Sadushi** – E saktë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull?

**Sokol Sadushi** – Është e vërtetë!

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me mirëkuptimin.

Miratohet neni 3, me ndryshimet.

Neni 10. Shtohet...

**Sokol Sadushi** – Më falni, nëse mundem, lidhur me nenin që kaloi edhe me dy nenet, ju bëtë pyetje seancën e kaluar dhe ne i mbajtëm shënim. Në fakt, reflektuam lidhur me: “Pse të ketë dy votime nga ana e Gjykatës së Lartë për gjyqtarin dhe pse te Kuvendi është vendosur marrja e opinionit nga rektoratet e universiteteve, nga organizatat, nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë e të tjera? Ndoshta ngelet në vlerësimin tuaj, por ne sugjerojmë që marrja e opinionit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, nga rektoratet e universiteteve, nga organizatat e shoqërisë civile e të tjera të shtrihet në të tria organet.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Sokol Sadushi** – E kemi si sugjerim dhe vlerësojeni ju.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo, ne e bëmë që radhën e kaluar dhe menduam që e keni marrë në konsideratë, por, gjithsesi, okej.

**Sokol Sadushi** – Edhe për emërimin me dy faza të gjyqtarëve nga Gjykata e Lartë, ndoshta duhet të ndjekim të njëjtën teknikë si me Kuvendin, edhe me...

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, dakord.

Miratohet me ndryshimet që u thanë, i parashtroi edhe relatori dhe prandaj e morëm të mirëqenë.

Vazhdojmë me nenin 10 “Zgjedhja e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** – Ne kemi bërë një ndryshim te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Pyetja është: a është e nevojshme që atë që ne e kemi thënë në Kushtetutë, ta kemi edhe në ligj? Përderisa kjo është e përkohshme, a mund të ishte si pjesë e dispozitës kalimtare, se do të bëhet përtëritja deri në vitin 2022?

**Sokol Sadushi** – Më fal, jeni duke folur për nenin 7/dh, se ne kemi në vëmendje nenin 7/d?

**Vasilika Hysi** – Neni 7/d ka mbaruar, jam te neni 7/dh.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka mbaruar neni 7/d.

**Vasilika Hysi** – Ju kërkoi ndjesë. E kam fjalën për nenin 7/dh.

**Fatmir Xhafaj** – A keni diçka për nenin 7/d?

**Sokol Sadushi** – Lidhur me ndërhyrjen e parë, pse ka zënë vend në Kushtetutë, në fakt, nuk ka zënë vend në Kushtetutë, e kemi hequr nga drafti kushtetues kur e kemi paraqitur zgjedhjen e kryetarit, prandaj ka zënë vend në ligj.

**Fatmir Xhafaj** – Po, kemi rënë dakord të lehtësojmë normën kushtetuese dhe detajet të parashikohen në ligj, kështu që kemi bërë mirë.

Për nenin 7/d kam unë diçka. Kemi dy versione: një opion është ai që është në trupën e amendamentit, pra zgjedhja e kryetarit të gjykatës për një periudhë trevjeçare me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë dhe një opion që është në *footnote*, që thotë pa të drejtë rizgjedhje, pra zgjidhet vetëm një herë kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjatë mandatit të tij një gjyqtar mund të ketë të drejtë të jetë vetëm një herë kryetar i Gjykatës Kushtetuese. A mund të na bëni një shpjegim ju, zoti Rainer, zoti Sadushi?

Urdhëroni, zoti Deville!

**Rainer Deville** – (*flet anglisht*) Një nga përpjekjet kryesore të kësaj reforme është lufta kundër korrupsionit dhe mjeti standarti për luftën e korrupsionit është rotacioni. Do vlerësoja që me rotacionin çdo tre vjet të gjykatës, të rizgjidhet dhe kryetari. Ky është mjeti standard për të luftuar korrupsionin. Nëse shikojmë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, ata janë *primus inter pares*, kryetari është i parë ndërmjet të barabartëve dhe më pas kjo duhet të ndryshojë. Kjo do të garantojë që të ketë më pak mundësi ndërhyrje në Gjykatën Kushtetuese dhe më pak ndikim. Kjo do të vlejë në qoftë se është për 9 vjet e ndarë në 3-3-3. Mund të argumentohet se për administratën e Gjykatës do ishte më mirë të ishte dikush i qëndrueshëm, por lufta ndaj korrupsionit dhe rotacioni janë mjete të rëndësishme dhe duhet të reflektohet në mënyrë të veçantë në këtë gjykatë. Është shumë e rëndësishme pasi dhe Bashkimi Evropian po shikon nga afër që mjetet për luftën ndaj antikorrupsionit po merren parasysh seriozisht. Do sugjeroja që kryetari të rizgjidhej çdo tre vjet.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Deville!

Fjalën e ka zoti Majko.

**Pandeli Majko** – Unë do ta kundërshtoj pak zotin Deville tani. Është hera e parë që i kundërshtoj opinionet e tij, të cilat i vlerësoj në mënyrë maksimale, por mendoj se, nëse korrupsioni mbeti të Gjykata Kushtetuese, këtë vend e ka marrë lumi. Në koncept

kërkoj një gjykim edhe nga zoti Sadushi, i cili ka dy eksperiencë, një si ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe një tjetër si ekspert, pra edhe nga brenda, edhe nga jashtë. Me thënë të drejtën, unë jam që të mbetet kështu siç është, sepse nuk mendoj se *primus inter pares* do të ketë një super influencë në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

E dyta, do ta shikoj edhe në pikëpamjen e modelit matematikor. Pra, kemi nëntë anëtarë dhe secili ka të drejtë të zgjidhet vetëm një herë, në qoftë se do ecim me logjikën që propozoi zoti Deville, por nuk e di sa efikase do të ishte kjo për të identifikuar personat, të cilët do të ishin boshti administrativ i Gjykatës Kushtetuese. E nënvizoj se të gjitha ato që thashë i konsideroj të rishikueshme, nëse dëgjoj një opinion, i cili do të m'i rrëzonte në mënyrë të arsyetuar.

Zoti Sadushi, do t'ju lutesha të bënit një koment!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Sokol Sadushi** – Në fakt, kjo është një çështje për të cilën në pamje të parë mund të duket sikur të dyja argumentet vlejné, si e drejta e rizgjedhjes, ashtu edhe kufizimi i kësaj të drejte. Arsyeja pse kemi vendosur këtë formulim me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë (natyrisht që kemi pasur debat brenda grupit, por opinioni mbizotërues ka qenë ky) lidhet me një pozicion ndryshe që do ta ketë nesër kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në raport me atë që parashikon Kushtetuta aktuale. Konkretisht, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në qoftë se do të pranohet që të zgjidhet nga politika, siç bëhet sot, ne do të ishim të gjithë në një mendje që të mos rizgjidhet. Ndërkohë, për sa kohë ka ndryshuar formulimi, sepse kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga vetë trupa, është një argument.

Argumenti i dytë është që në draftin e ligjit të Gjykatës Kushtetuese janë kufizuar kompetencat e kryetarit. Pra, kryetari nuk ka më atë pushtet që ka pasur apo që ka tani me ligjin ekzistues.

Një arsye tjetër lidhet me faktin që, duke menduar perspektivën, një kryetar i Gjykatës Kushtetuese, që mund të jetë me të vërtetë një figurë e pëlqyeshme për tre vjet, për sa kohë gëzon një reputacion mjaft të mirë dhe trupa e zgjedh, nuk ka arsye pse t'i kufizohet kjo e drejtë. Domethënë, kanë qenë këto argumente që ne kemi përdorur këtë formulim.

Për t'u marrë në konsideratë është edhe argumenti tjetër, por ne më shumë i qëndrojmë argumentit që kemi sjellë përpara jush. Nga përvoja ime, meqenëse m'u drejtua si pyetje, unë më shumë prirem nga ideja që të jetë e mundur një mundësi rizgjedhjeje; të mos ndalohet. Nuk dëshiroj domosdoshmërisht të rizgjidhet, por të mos pengohet. Mendoj se bën një dëm më të madh pengimi se e drejta për t'u lejuar, sepse, në fund të fundit, do ta zgjedhë vetë trupa dhe ata e dinë se kë zgjedhin kryetar. Besoj se ata do të duan një kryetar që të jetë një figurë me reputacion dhe kjo është e drejtë e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, unë përsëri kam një pyetje për ju dhe për zotin Rainer. Në praktikën e gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera, kryetari i gjykatës është me një mandat, apo është me mundësi rizgjedhjeje? Cili do të ishte disavantazhi, nëse do të lihej vetëm një mandat, pra të kishim një farë demokracie dhe një gjithëpërfshirje, që t'u jepet mundësi edhe anëtarëve të tjerë të gjykatës?

**Sokol Sadushi** – Përgjithësisht pranohet përvoja e vendeve të tjera që kryetarët nuk kanë kufizime në mandat. Është në të drejtën legjitime të trupës për të zgjedhur atë që ata mendojnë se do t'i drejtojnë. Kështu që nga kjo pikëpamje, unë e thashë edhe pak më parë, duket më e arsyeshme, kjo duke besuar se prurja në Gjykatën Kushtetuese do të jetë shumë më e mirë nga ç'ka qenë. Kushtetuta këtë lloj frymëmarrje kërkon të japë, edhe ligji për rrjedhojë këtë kërkon të japë që mundësisht, nëse kandidaturat janë të pëlqyeshme, le ta zgjedhë vetë trupa më të mirin. Më i miri mund të jetë edhe ai që mund të ketë qenë kryetar. Nga kjo pikëpamje, ndalimi do të ishte i rrezikshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Deville.

**Rainer Deville** –(*flet anglisht*) Vendet e tjera nuk kanë sistem drejtësie të korruptuar dhe ndoshta ky është dallimi përse ne po bëjmë këtë reformë sot në mënyrë që të jemi të qartë se çfarë po bën Shqipëria për të pastruar dhe parandaluar çdo lloj korrupsioni. Në rast se kjo qëndron, ju duhet të jeni të përgatitur të merrni një koment negativ nga progres raporti pasi Bashkimi Evropian është shumë i ndjeshëm dhe shpreson që Shqipëria është duke bërë çdo gjë, në detaj për të parandaluar korrupsionin. Sa më shumë argumente jepni, aq më e vështirë është. Do shikoni se pasja e rotacionit nuk ka asnjë gjë të keqe. Ky është mjet standart për të luftuar korrupsionin. Nuk ka asnjë *acquis* në lidhje me këtë dhe sigurisht ju mund të vendosni ndryshe, por do të krijoni një

dritë të kuqe në lidhje me seriozitetin e reformës në luftën kundër korrupsionit. Doja vetëm ta përmendja në mënyrë që të mos surprizoheni, nëse Bashkimi Europian e konsideron këtë ndryshe.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Majko, keni fjalën.

**Pandeli Majko** – Unë si relator do ta kundërshtoj pak zotin Rainer. Nëse ne do të mendojmë se çështja e korrupsionit lidhet me një statutskuo të caktuar numerike brenda një trupe, atëherë më lejoni të them se përgjigjja mund të jetë inverse, e njëjta statuskuo mund të zgjedhë dikë tjetër dhe në thelb nuk ka ndryshuar asgjë. Ku e kam fjalën? Nëse do të kemi një trupë, e cila nënkuptohet se dëshiron të ruajë linja korrupsioni apo lobimi korruptiv, atëherë çështja e kryetarit është krejtësisht një detaj teknik dhe vetëm kaq. Kjo në thelb nuk do të kishte të bënte me luftën e korrupsionit, pra çështja e rotacionit. Unë më tepër do ta shikoja si një balancim të brendshëm. Do të kemi një trupë, e cila do të votojë në mënyrë të fshehtë, një herë në tre vjet, do të jetë trupa që në thelb... Masa më antikorrutive, sipas meje, është që do të vijnë nga tri drejtime të ndryshme, pra Gjykata Kushtetuese esencialisht do të krijohet nga tri drejtime të ndryshme, siç e thamë: 3, 3, 3, dhe mendoj se ky është fenomeni më fundamental i moslobimit korruptiv në vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese dhe jo votimi i fshehtë i një trupe prej 9 vetash, se kush do të jetë kryetari administrativ dhe përfaqësues i saj. Megjithatë, do t'i qëndroj faktit që të lihet e drejta për t'u zgjedhur edhe një herë dhe nuk besoj se do të jetë moment korruptiv. Po dyshuam se ky është moment korruptiv në një gjykatë dhe ta diskutojmë këtë si parim, atëherë le të themi që deputet mund të zgjidhesh vetëm një herë, sepse, po u zgjodhe dy herë, je nën influencën e korrupsionit; do të zgjidhesh President vetëm një herë, nuk duhet të zgjidhesh dy herë, se je nën efektin e korrupsionit e kështu me radhë. Domethënë, kjo na hap një diskutim, i cili dihet se ku fillon, por nuk dihet se ku mbaron.

**Fatmir Xhafaj** – A ka opinione të tjera për këtë gjë?

Mbetemi siç është me nenin 10.

Neni 11/7”dh” “Përtëritja e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** – Unë po ripërsëris edhe një herë pyetjen, meqenëse e bëra para kohe. Në këtë nen ka një parashikim që është kalimtar. Pra, sesi do të bëhet përtëritja e gjykatës deri në vitin 2022 e kështu me radhë. A nuk do të ishte më mirë që të

parashikohej si dispozitë kalimtare përtëritja e Gjykatës Kushtetuese, sepse kjo është e përkohshme, pra nuk do të jetë gjithë kohës? Kjo është derisa të bëhet përtëritja në fazën kalimtare.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Ju keni të drejtë faktikisht, sepse kjo është një dispozitë kalimtare. Në fakt, në pamje të parë nuk e ka vendin këtu dhe ne nuk kemi ndonjë kundërshtim për sa i përket këtij aspekti. Arsyeja pse e kemi vendosur këtu është se ndoshta e kemi parë të arsyeshme për vetë kreun...

**Fatmir Xhafaj** – Më duket se ka të drejtë.

**Sokol Sadushi** – Jo plotësisht.

Ka të drejtë me aq sa argumentoi, ashtu siç ka të drejtë vetëm për ta spostuar në dispozitën kalimtare. Ndërkohë, ditën e mëparshme tha të mos vendoset, sepse e ka dispozita kushtetuese. Zonja Vasilika e bëri dy herë pyetjen, prandaj e nisa nga pozitiviteti për të kaluar.

**Fatmir Xhafaj** – Thelbi është se nuk e ka vendin këtu.

**Sokol Sadushi** – Është e vërtetë: që një dispozitë kalimtare nuk e ka vendin në trungun e ligjit, mund të kalojë siç është, pavarësisht se ka edhe formulim që lidhet me ripërtëritjen dhe me mënyrën sesi zëvendësohen në vijimësi, që është pika 3, germa “d”. Pra, pika 3 nuk ka lidhje me dispozitën kalimtare.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Anastasi!

**Aurela Anastasi** – Jam dakord që duhet të mbetet diçka nga kjo dispozitë. Ne kemi një eksperiencë të dështuar deri tani në lidhje me rotacionin dhe me përtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, e pazbatuar asnjëherë. Kuvendi, në vend që të miratonte ligjin dhe të parashikonte deri tani përtëritjen e Gjykatës Kushtetuese që të kryejë dhe të zbatohet Kushtetuta, që nga viti '98 Kushtetuta nuk është zbatuar asnjëherë në këtë pikë jo vetëm që nuk ka miratuar ndonjë ligj, por ka paraqitur kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, të cilat janë thjesht kërkesa për të shtyrë procedura votimi e të tjera si këto. Kështu që unë e shikoj një çështje shumë të rëndësishme, madje jam gati që të bëjmë ndonjë formulim më të përgjithshëm, por diçka duhet të mbetet.

Për sa u përket pikave të tjera, që janë kalimtare, jam dakord, mund edhe t'i çojmë deri në fund. Kjo ka qenë arsyeja që ne i kemi vendosur.



**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë nuk po diskutoj se ky nen nuk duhet të jetë “Përtëritja e përbërjes së gjykatës”, sepse ky është parim i përgjithshëm. Unë flas vetëm për paragrafin e dytë, por kalimi i paragrafit të dytë si dispozitë kalimtare, bën që ky nen të ketë paragraf të parë dhe 3-shi të bëhet 2-sh dhe kërkon kujdes, sepse tek treshi duhet reflektuar referenca.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, biem dakord? Dakord me ndryshimet.

Miratohet.

Nenin 12. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 13 “Mbarimi i mandatit”.

A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 14, pas kreut II shtohet kreu II/1 me titull “Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”.

Besoje se jeni dakord? Keni ndonjë gjë me këtë?

Dakord me vendosjen e një kreu të ri.

Atëherë, vazhdojmë me përmbajtjen që ka ky kreu, që është neni 10 “Shkeljet disiplinore”.

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** - Te neni 10 kam një pyetje për pikën 3, ku thuhet: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore për shkak të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët për mosnjohim të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera”.

Kur thoni “ndikim i papërshtatshëm” e keni fjalën për ndërhyrje? Në pikën 4 ju thoni: “Ndërhyrje dhe çdolloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm”. Nga dallon “ndërhyrja” nga “ndikim i papërshtatshëm”? Mendoj se, edhe për efekt të debatit kushtues, edhe të ligjeve dhe për ta kuptuar më pas se kush do të quhet “ndikim i përshtatshëm”, “ndikim i papërshtatshëm”, unë nuk e di cili është ndikim i përshtatshëm i funksionarëve politikë? “Ndikimin e papërshtatshëm” e kuptoj, por “ndikimin e përshtatshëm” nuk arrij ta kuptoj, apo “ndikimin e funksionarëve të subjekteve të tjerë”.

Gjithashtu, te pika 8 kam një pyetje, sepse ndoshta mund të ketë nevojë për një riformulim. Ju thoni: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore për shkeljet e përsëritura të rregullave në marrëdhënie me “administratën dhe punonjësit e tjerë”. A nuk do ishte më mirë për ta bërë dallimin “administratën dhe punonjësit e tjerë”. Kush janë në Gjykatën Kushtetuese punonjësit e tjerë, përveç atyre që janë administratë? Administrata janë nëpunësit e shërbimit civil, apo keni dhe punonjës të tjerë, për ta saktësuar? Këtë do të doja ta sillnit në përshtatje me nenin 22, i cili ndryshon nenin 14 të këtij projektligji.

Lidhur me pikën 13 ju thoni: “Parashtrim të dukshëm të shtrembëruar të fakteve të nxjerra”. Pra, gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore për parashtrim të dukshëm të shtrembëruar të fakteve. Ndoshta është përkthyer nga anglishtja dhe...

Po në pikën 14: “Përdorimi i mandatit të gjyqtarit me qëllim për të realizuar përfitime të pajustificuara dhe avantazhe për veten”. Mos e keni fjalën për përfitime?

Te pika 15 ju thoni: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese ka përgjegjësi për shoqërimin me persona që janë në ndjekje penale, janë subjekt të një procedimi penal ose me persona të dënuar”. Fjala është të dënuar penalisht apo civilisht, administrativisht, se kur thua “persona të dënuar” është lënë e gjerë?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Në fakt, mund të ketë diçka lidhur me përdorimin e fjalës, me saktësinë e termit, por lidhur me pyetjen që ju bëtë te pikat 3 dhe 4, duket sikur është i njëjti formulim, por nuk është i njëjti formulim, sepse në pikën 3 bëhet fjalë për rastet kur nuk njofton kryetarin e gjykatës, se është ndikuar në mënyrë të papërshtatshme nga avokati, nga funksionarët publikë dhe subjekte të tjera. Ndërsa në pikën 4 bëhet fjalë kur ndikon në mënyrë të papërshtatshme me ushtrimin e tyre si gjyqtarë, pra “gjyqtari ndaj gjyqtarit”. Ndërsa në pikën 3 është “të tjerët ndaj gjyqtarit”, kjo është një diferencë e vogël.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, a ka ndikim të përshtatshëm nga politikani te gjyqtari?

**Sokol Sadushi** – Në fakt, edhe ne mund ta shikojmë me vëmendje këtë pjesë, por po përpiqem të them këtë lloj diferencë, që ekziston midis pikës 3 dhe 4. Nga

ndikimi i papërshtatshëm me ndërhyrjen e papërshtatshme, faktikisht, ne nuk bëjmë një dallim, pasi këtë formulim e kemi marrë ashtu siç është te ligji “Për statusin e gjyqtarit”. Kjo është një diçka që ka nevojë për t’u parë me më shumë kujdes nëse mund të evidentohet ndonjë fjalë, por i gjithë qëllimi është për të evituar ndikimet, ndërhyrjet apo presionet që bëhen ndaj gjyqtarit.

**Aurela Anastasi** – Ka konotacion, ndërhyrja bëhet më personalisht.

**Sokol Sadushi** – Unë do të mendoja që të qëndrojnë si dy terma të veçantë, sepse ndoshta mund t’i gjendet kuptimi gjithsecilit ndryshe nga tjetri. Ndryshe është ndikimi dhe ndryshe është ndërhyrja. Për shembull, ndërhyrja është në kuptimin që ndërhyrja për të zgjidhur një çështje, kurse ndikimi është edhe një lloj presioni, që vjen për shkak të funksionit që mund të ketë dhe lidhet edhe me ofrimin e parave.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, do që të qartësohem unë, ndoshta jam unë e paqartë për ju.

Ju thoni: “Ndikim të papërshtatshëm nga funksionarët politik”, unë them se funksionarët politik nuk mund të ndikojnë fare as në mënyrë të përshtatshme, as në mënyrë të papërshtatshme. E kuptoni?

**Aurela Anastasi** – Ne nuk jemi fare për termin “i papërshtatshëm”.

**Vasilika Hysi** – Çdo ndikim. Avokati mund të ndikojë? Këtë po them, sepse nuk mund të ketë “ndikim të përshtatshëm” dhe “ndikim të papërshtatshëm”. Ju e keni gjetur diku këtë term, e keni marrë nga ndonjë legjislacion tjetër dhe duhet kuptuar kur është “ndikim i përshtatshëm”? Kur një funksionar publik mund të bëjë një “ndikim të përshtatshëm” të gjyqtarit për një çështje?

**Sokol Sadushi** – Mund të keni shumë të drejtë, dhe unë e thashë, për të qenë i sinqertë me ju, ky është një formulim që ne e kemi marrë siç në ligjin “Për statusin gjyqtarit dhe të prokurorit”. Ka pasur një debat lidhur me këtë çështje, nëse do të zëre vend në ligjin e Gjykatës Kushtetuese ky nen apo jo? Për sa kohë që nuk gjej argument tjetër, më duket më e saktë që ta lëmë sesa ta heqim, sepse ndoshta për momentin nuk mund të mos japim një arsye të fortë që duhet njëra apo tjetra.

Sidoqoftë, ne do të përpiqemi të gjejmë një pastërti të gjuhës në drejtim të këtyre termave, për ta parë me kujdes edhe në funksion të ligjit tjetër.

Për sa i përket pikës 8, lidhur me “administratën dhe punonjësit e tjerë të gjykatës”, arsyeja është e lidhur me nenin 22. Në nenin 22 është bërë një lloj përkufizimi apo një lloj zbërthimi i konceptit “administratë e gjykatës” dhe nuk janë të gjithë punonjësit e tjerë, janë vetëm nëpunësit civilë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Keni shumë të drejtë në këtë pjesë, sepse këtu është futur edhe fjala “punonjës të tjerë”, ndërkohë ne kemi pasur tjetër gjë në mendje. Dakord do ta korrigjojmë këtë pjesë.

**Fatmir Xhafaj** – Ka tjetër gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Sokol Sadushi** – Në pikën 13 “Parashtrimi të dukshëm të shtrembëruar të fakteve në akset e nxjerra”.

**Aurela Anastasi** - Zonja Vasilika, ju e keni fjalën se nuk shkon “i dukshëm dhe i shtrembëruar” bashkë? E kuptova, “shtrembëruar”, nuk ka nevojë “i dukshëm”, kështu e kuptova pyetjen tuaj.

**Sokol Sadushi** – Lidhur me pikën 15, ideja më tepër është për personat e dënuar penalisht, sepse kur fillon fjalja, gjithmonë fillon me persona që janë në ndjekje penale apo subjekte të procedimit penal dhe shkon në logjikën e personave të dënuar penalisht.

**Aurela Anastasi** – Kemi dhe pyetjen për fjalët “përfitime dhe avantazhe”.

**Sokol Sadushi** – Do ta saktësojmë këtë.

**Aurela Anastasi** – Mund të ketë përfitime, favore, mund ketë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Besoj se u sqaruam për një pjesë.

Urdhëroni, zoti Deville!

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Nga pikëpamja e teknikës legjislative, do preferoja që shkeljet disiplinore të bëhen duke iu referuar ligjit, ku janë përcaktuar shkeljet e tjera disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë që përmban ligji për statusin. Nga ana legjislative, kjo është paksa e ndërlikuar. Shkeljet disiplinore janë vetëm ato që ligji përcakton shprehimisht. Ajo që duhet të themi në fjalinë e parë është: “Nëse gjyqtari kryen aktet e mëposhtme...”. Mund të jenë qindra shkelje të cilat nuk i kemi përcaktuar. Ky është një kufizim i shkeljeve disiplinore pasi ato duhet të jenë të listuara. Duhet të

kemi përgjegjshmëri për çdo lloj shkelje edhe nëse nuk i kemi këtu, duhet ta lëmë të hapur. Nëse shikojmë nenin 60 thuhet: "...se kemi përfitime të padrejta për shkak të funksionit". Fjala "e padrejtë" është vështirë për t'u përcaktuar. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të pranojnë asnjë dhuratë për shkak të funksionit. Formulimi është shumë kufizues për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Ky është një shqetësim tjetër që vëmë re në këtë ligj pasi çështja e përgjegjshmërisë nuk është marrë seriozisht.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Ka komente për këtë? Besoj se jemi dakord për këtë pjesë?

Atëherë, dakord neni 14, me ndërhyrjet që u bënë, sqarimet i dha zoti Deville, dhe dakordësinë që ramë për vërejtjet dhe ndryshimet e sugjeruara.

Faleminderit!

Neni 15.

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje për paragrafin e parë. Konkretisht, ju thoni në paragraf. "Kur ka të dhëna të mjaftueshme që është kryer një shkelje, kryetari merr masat për fillimin e procedimit disiplinor". Kush e urdhëron fillimin e procedimit disiplinor? Mos ndoshta duhet të themi "fillon, vepron, merr masat", pra hedh shortin e tjerë?

Pyetja tjetër ka të bëjë me paragrafin e dytë. Ju thoni: "Procedimi disiplinor fillon brenda 3-muajve nga konstatimi i shkeljes". Pse është lënë kaq kohë kur është flagrante? Pse nuk mund të fillojë procedimi disiplinor menjëherë? Pse është lënë jo më vonë se një vit? Këtë lloj pyetjeje e bëj edhe për të pasur rekorde, për të pasur qartësi për të mos pasur gjatë zbatimit të ligjit pretendime lidhur me vonesa, shtyrje, ndikime e të tjerë. Pra, të më falni, një sërë pyetjesh i bëj edhe për të pasur qartësinë se çfarë keni dashur ju duke bërë këtë lloj parashikimi.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Është e vërtetë që në pamje të parë mund të gjesh teknologji, që të krijon një përshtypje jo të qartë, por ideja është se kryetari merr masa, në kuptimin që organizon trupën për të filluar procedimin disiplinor dhe mënyra sesi është procedimi disiplinor është në pikat 2, 3, 4, 5 dhe në vijimësi.

Në këtë rast, kryetari nuk ka ndonjë kompetencë, përveçse mbledh trupën dhe, mbi këtë bazë, fillon procedimi. Pra, nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta. Në vijimësi do të jetë mbledhja e gjyqtarëve që do të vendosë nëse do të vendoset pezullimi i gjyqtarit për shkak të fillimit të procedimit disiplinor, apo jo. Fakti që mblidhen dy gjyqtarë, të cilët caktohen me short, tre gjyqtarë të tjerë që do të jenë, është pjesë e një iniciativë që kërkohet nga kryetari për të vendosur trupa se si do të vepohet në këtë rast që na është paraqitur.

Në fakt, edhe këtu ne kemi qenë pak në vështirësi, sepse është një procedurë e re për gjyqtarët kushtetues dhe kemi dashur të vendosim një lloj rehabilitimi nëse ndërkohë nuk vepron gjykata, që është përgjegjësi e saj, nëse kalon një vit, ose edhe për të dhënë efekt parashkrimi të shkeljeve disiplinore. Mendojmë se një gjykatë e përgjegjshme vepron menjëherë.

Po pse tre muaj? Mund të ketë shumë rrethana. Duhet të lëmë një hapësirë. Mund të jetë periudhë vere dhe nuk mund të vendosim afate të ngurta me qëllim që të evitojmë fillimin e procesit disiplinor. Afati është afat, ne e kemi menduar 3 muaj. Nëse duhet ta afrojmë, kjo është një çështje që e vlerësoni ju. Me këto afate nuk përjashtohet nga ndëshkimi disiplinor një gjyqtar kushtetues. Nuk janë afate që e lënë jashtë vëmendjes procedimin disiplinor.

**Fatmir Xhafaj** – A ka tjetër?

Biem dakord, besoj.

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Ky është një shembull tjetër ku përgjegjshmëritë nuk trajtohen me aq seriozitet. Ne mendojmë se kjo është një mundësi për të vonuar procesin, madje edhe për ta ndaluar atë. Ne kemi parë në çështjet e mëparshme disiplinore ku gjyqtarët mundën ta eliminonin sanksionin disiplinor, thjesht vetëm duke pritur. Unë mendoj që nuk është ajo që duam të themi. Mendoj që kjo fjali duhet të hiqet sepse krijon edhe më shumë probleme. Përse na duhen këto afate kohore? Mendoj se ato mund të keqpërdoren.

**Vasilika Hysi** – Unë mbështes shqetësimin që shprehu zoti Rajner. Unë mendoj se procedimi disiplinor fillon menjëherë, se mund të ketë raste flagrante, mund të daljë nevoja që ta pezullosh gjyqtarin, apo ta shkarkosh menjëherë, por ta lësh tre muaj që ai të vazhdojë, madje jo më vonë se një vit, ndjesë, me gjithë respektin që kam për gjyqtarët e

Gjykatës Kushtetuese, por edhe atyre që do të dalin nga vetingu, nuk duhet t'u japim hapësira që ai të fillojë menjëherë procesin. Kryetari i gjykatës, sapo konstaton se ka të dhëna të mjaftueshme se një gjyqtar ka bërë një shkelje, menjëherë e inicion, merr masa, siç e thoni ju. Por nuk mund ta lësh 3 muaj sa të mbarojë gjyqin.

**Sokol Sadushi** – Më falni ta saktësoj, është neni 18, pika 2, që jep procedurën si vepron kryetari. Shqetësimi juaj e gjen veten te pika 2, sepse përfshin edhe fillimin e procedimit disiplinor, edhe rastin e arrestit në flagrancë, pra masës së arrestit me burg, edhe në cilësinë e të pandehurit. Pra, sipas këtij neni, kryetari ose gjyqtari më i vjetër, kur është kryetari, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit thërret mbledhjen. Pra, shqetësimi juaj e gjen veten te ky nen, sepse kryetari me t'u vënë në dijeni, brenda tre ditëve, thërret mbledhjen. Mbledhja vendos nëse do të merret masa e pezullimit, pra edhe për fillimin e procedimit disiplinor apo jo. Nga ky moment gjyqtarët do të veprojnë sipas rregullave të nenit 15, që përcakton fillimin e procedimit disiplinor. Nuk besoj se ky tre muajsh që është parashikuar, në fakt, është maksimal, por nuk pengon që ta fillosh. Detyrimi i kryetarit për mbledhjen është brenda 3 ditëve.

**Fatmir Xhafaj** – Mund të jetë abuzive kjo, pasi, meqë ka afat 3 muaj, ai mund të thotë: po e mbaj tre muaj, po e mbaj një vit.

**Sokol Sadushi** – Është pika 2 e nenit 18 që e detyron ta mbledhë brenda 3 ditëve.

**Fatmir Xhafaj** – Minimalisht, nuk ka pse të jenë kaq të gjata si afate, sepse, për sa kohë që mund të mos jetë ai në kushtet e konstatimit, jam dakord, por, kur ai e konstaton, çfarë pret.

**Sokol Sadushi** – Zoti kryetar, unë po e shpjegoj se pika 2 e nenit 18 e detyron kryetarin që brenda 3 ditëve ta mbledhë 3 muaj është afati maksimal, jo se është e drejta e tij. Ne mund ta zvogëlojmë 3 muajshin, por përsëri 3 ditëshi nuk bie.

**Fatmir Xhafaj** – Po ç'kuptim ka të rrijë afati 1 vit? Ai mund të thotë se kam kohë deri në një vit. Nuk ka sens kjo.

**Sokol Sadushi**- Më falni 1 vitëshi është...

**Fatmir Xhafaj** - Edhe në republikën suedeze nuk do të ishin kaq...

Dakord.

Rishikojini afatet, bisedojeni me njëri- tjetrin dhe gjeni një zgjidhje që të jetë e përshtatshme.

Neni 15, miratohet me ndryshime.

Neni 16. Masat disiplinore.

**Vasilika Hysi** – Unë mendoj se është gabim në referencë pika 2, ku thuhet: “Gjatë kohës së procedimit disiplinor gjyqtari pezullohet nga detyra sipas nenit 10/c”.

Neni 10/c flet për procedurën e shqyrtimit të shkeljes, ndërsa pezullimin rregullohet në nenin 10/ç. Është e saktë?

**Sokol Sadushi** – Ka ndodhur diçka. Për shkak të lëvizjes së disa dispozitave, ndoshta ne nuk kemi arritur dot të bëjmë qartësimin e referencës. Kështu që, këtu keni të drejtë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 10/b “Masat disiplinore”. Dakord me ndryshimin që u tha.

Vazhdojmë me nenin 17.

**Rainer Deville** - (*flet anglisht*) Pësra i përket sanksioneve disiplinore puna duket paksa e çuditshme. Vendimi disiplinor nuk do të thotë miratim i raportit. Vendimi disiplinor ka të bëjë me atë që ose mund të merret një vendim disiplinor, ose ai mund të mos merret. Në raport nuk është sugjeruar mjaftueshëm vendimi disiplinor. Pika 1/a duhet të vendosë një masë disiplinore jo domosdoshmërisht ndonjë të përfshirë në raport, kështu që mund të vendoset ndryshe dhe kjo nuk ka të bëjë me hedhjen poshtë të raportit, apo imponimin e një mase disiplinore. Ky është vendimmarrja e tij nëse jepet. Mendoj që këshillimi ligjor për çështjet, duhet të bëhet vetëm në rastet e jashtëzakonshme. Normalisht, nëse diçka ka nevojë të rishikohet dhe mund të bëhet në mënyrë të menjëhershme, duhet të procedohet në këtë mënyrë. Vendimi disiplinor nuk është miratimi i raportit, vendimi disiplinor përbën vetë sanksionin.

**Sokol Sadushi** – Ka të drejtë zoti Rainer, sepse, në fakt, mund të ndodhë që të ndryshojë masa disiplinore dhe, kështu siç është formuluar, ndoshta nuk është e saktë. Ndoshta mund të themi: “dhënien e masës disiplinore”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Dakord neni 17 me ndryshimin.

Faleminderit zoti Rainer!

Vazhdojmë me nenin 18.



Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Te neni 18, paragrafi 2 unë mendoj se duhet saktësuar kur thuhet: “kryetari ose gjyqtari më i vjetër”, në moshë apo në detyrë.

Këtë sugjerim e kam edhe për nenin 20, ku ju thoni: “gjyqtari më i vjetër”.

**Sokol Sadushi** - Nuk kemi guxuar të vendosim moshën apo detyrën, por kemi lënë atë që Venecia na ka thënë. Në opinionin fillimisht kishim vënë moshën, por ata na thanë duhet “detyrën”, kështu që presumohet detyra. E ka ndryshuar Venecia dhe ne kemi ecur me logjikën e detyrës. Në fakt, mendoj më mirë që është me detyrën, sepse mund të ndodhë që një gjyqtar i ri në moshë, mund të ketë eksperiencë në gjykatë dhe nuk ka pse të jetë një që është me moshë më të madhe, që sapo ka ardhur, ta drejtojë. Domethënë edhe kjo është një arsye, kështu që “me detyrë” është më korrekt.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Neni 18 dakord me ndryshimin e propozuar.

Neni 19.

Te neni 19 shtohet: “Neni 11 shfuqizohet”.

Neni 11, ekzistuesi?

**Sokol Sadushi** – Neni 11 “Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga kryetari i saj dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej gjyqtarëve të caktuar prej tij, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është i përcaktuar në kompetencë të mbledhjes së gjyqtarëve”. Ka gjetur vend më pas.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Te kompetencat e kryetarit, te mbledhja..

**Vasilika Hysi** – Ndjesë, nga pikëpamja e teknikës legjislative, nuk e keni shfuqizuar, sepse ju nga neni 11 i keni dhënë numrin 12, kur thoni “Kompetencat e kryetarit”. Nëse e kuptova korrekt, zoti Sadushi, ju lexuat nenin 11, sikurse është te neni 12: “Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet, organizohet nga kryetari”. Atëherë, pse mos të shtojmë te neni 11 bashkimin? Unë nuk arrij të kuptoj se çfarë është bashkuar, përveçse është shtuar. Duke mos pasur parasysh ndryshimin, nuk e kuptoj pse duhet shfuqizuar neni 11. Ju e keni aktualisht. E keni riformuluar, në dijeninë time, apo jo, nëse jam korrekte?

**Sokol Sadushi** – Në nenin 12 shtohet paragrafi 1 me këtë përmbajtje. Pra, në nenin 12 të ligjit ekzistues është shtuar paragrafi që ne e kemi vendosur si neni 12, është

bërë me dy paragrafë. Pra, neni 12 ekzistues është bërë me dy paragrafë. Kemi hequr nenin 11 ekzistues dhe e kemi përfshirë te neni 12. Kjo ka qenë arsyeja, sepse neni 12 bën fjalë për kompetencat e kryetarit. Thjesht kemi bashkuar dy nene në një.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Dakord me nenin 19, shfuqizimin e nenet 11.

Vazhdojmë me nenin 20 pas kreut 2/1 shtohet kreu 2/2 me titull “Organizimi i Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Në nenin 12 shtohet paragrafi 1 me këtë përmbajtje: “Neni 12 “Kompetencat e kryetarit”. A keni pyetje për këtë?”

**Vasilika Hysi** - Në nenin 12 do të doja të shtohesh fjala “gjyqtari më i vjetër në detyrë”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord. Miratohet me ndryshimin e propozuar.

Neni 21 që ndryshon nenin 13 ekzistues “Kompetencat e mbledhjes së gjyqtarëve”.

Po, zonja Hysi, pyetje.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, unë kam një pyetje për kompetencën. Ju thoni që “mbledhja përcakton drejtimit kryesore të shpenzimeve”. Mos duhet thënë “përcakton drejtimit kryesore të përdorimit të mjeteve” dhe pastaj “të shpenzimit”? Pra, në radhë të parë të përcaktosh këtë shumë parash që buxheti i shtetit ia ka rialokuar, ku do të përdoret, në cilat drejtime, dhe pastaj të kontrollosh brenda këtyre drejtimeve, si janë shpenzuar. Kjo është rregulluar në germën “b”, “shpenzimi”.

**Sokol Sadushi** – Në fakt, germën “a” nuk e kemi ndryshuar nga ligji ekzistues, e kemi lënë siç është nuk kemi shtuar gjë. Pra, e kemi lënë siç është, në ligjin ekzistues. Pra, në germat “a” dhe “b” nuk kemi bërë ndonjë ndryshim. Janë shtuar pastaj tek të tjerët në vijimësi. Po besoj se është e qartë këtu, për Gjykatën Kushtetuese, ky problem nuk është shqetësim se çfarë kupton me përcaktimin e drejtimit kryesor të shpenzimeve buxhetore. Ata bëjnë vetëm thjesht ndarje, domethënë buxheti i shtetit përcakton shumën, kaq ka Gjykata Kushtetuese dhe i ndan në zëra, pastaj vetë gjykata në mbledhjen e gjyqtarëve vendos se ku do t’i përdorë këto fonde brenda zërave që ka vendosur buxheti i shtetit.

**Vasilika Hysi** – Unë këtë pyetje nuk e bëra pa qëllim. Ne në Komisionin e Ligjeve, kur shqyrtojmë zërat e buxhetit, përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese janë

paraqitur, kemi parë hera-herës një moskoordinim të prioriteteve dhe të përdorimit të fondeve. Kur kemi pyetur sekretarin e Përgjithshëm të gjykatës: pse këto para kanë shkuar tek infrastruktura dhe jo te biblioteka, ose pse kanë shkuar më shumë tek ec e jake, trajnimet, konferencat dhe jo, për shembull, te bërthama juridike ose këshilltarët, ai ka thënë se është kompetencë e tyre. Unë mendoj se mbledhja e gjyqtarëve duhet të vendosë një herë shtyllat, cilat janë përparësitë, ku duhen vendosur paratë në një vit financiar.

Së dyti, brenda tij si do të shpenzohen, pra transparenca e shpenzimit, sepse mund të shpenzosh para, por i shpenzon ato në mënyrë joefektive.

**Sokol Sadushi** - Besoj se e gjen kuptimin te shkronja “a”, mënyra se si përdoren mjetet buxhetore të Gjykatës Kushtetuese. Nëse do të shtohet vetëm një fjalë, “përdorimi”, ajo është e kuptueshme që derisa përcakton drejtimit kryesore, do të kontrollojë edhe verifikimin se si akordohen këto mjete buxhetore. Të paktën në përvojën time kjo gjë nuk ka qenë shqetësim, se si gjykata e kontrollon rimbledhjen, financën e saj.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Miratohet neni 21.

Neni 22 “Administrata e Gjykatës Kushtetuese”.

Po, dakord.

Neni 23 “Njësia e shërbimit ligjor” që pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje: “Njësia e shërbimit ligjor”.

Po, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** - Zoti Sadushi, kur ju pyeta për mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata e Lartë, ju thatë se rregullat duhen përcaktuar në këtë ligj. Kur vjen tani puna te zgjedhja e këshilltarëve ligjorë, ju nuk i përcaktoni rregullat në këtë ligj, por thoni sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Pra, këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese rregullohen te ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve” apo duhet të jenë këtu?

**Sokol Sadushi** – Për të shkuar në argumentin që sapo thatë ju, ne mund t’i përcaktojmë edhe këtu kriteret e ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”, por besoj se atje janë kodifikuar aq qartë saqë një referencë është e mjaftueshme. Ajo që kishte të bënte pak më parë me pyetjen tuaj ishte bazike, sepse lidhej me emërimin e

gjqqtarëve kushtetues dhe këta gjyqtarë duhet të kenë procedurë strikte se si emërohen dhe zgjidhjen, e për rrjedhojë procedura e Gjykatës së Lartë duhet të zinte vend këtu. Kurse kriteret dhe kushtet që përcaktohen në ligjin “Për statusin e gjyqtarit”, meqenëse këta do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, në kuptimin e këtij ligji janë përcaktuar atje. Sa të bënim një përsëritje të neneve, kemi menduar të përdorim referencën. Nuk besoj se kjo e dëmton projektin.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me paragrafin 4 sugjeroj të riformulohet: Kryetari cakton këshilltar ligjor për çdo çështje gjyqësore, duke marrë për bazë përvojën profesionale dhe ekspertizën e tij, sipas rregullores... Rregullores së kujt? Pra, duhet riformuluar togfjalëshi “për çdo çështje gjyqësore” të kalojë pas fjalës “cakton këshilltar ligjor” dhe “sipas rregullores të gjykatës”.

**Sokol Sadushi** – Keni të drejtë, sipas projektit ka dy rregullore, rregullorja e Gjykatës dhe rregullorja e brendshme e gjykatës. Rregullorja e gjykatës është procedurale dhe këtu duhet të vendoset rregullorja e gjykatës.

**Fatmir Xhafaj** – Po, tjetër?

*(Diskutim pa mikrofon)*

Jo, vetëm kam diçka. Ju thoni, në raste të veçanta, por jo më shumë se 1/5 e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjor në gjykatë mund të emërohen nga radhët e juristëve me përvojë jo më pak se 10 vjet, si lektorë të së drejtës e të tjera. Kam një pyetje: për një moment po abstrahoj dhe po them Gjykata Kushtetuese ka 9 gjyqtarë, 18 këshilltarë, pra 2 këshilltarë për një 1 gjyqtar apo 1 këshilltar, sepse nuk e di se sa mund të jetë njësia këtu, mund të jetë edhe 20 veta, për mua nuk ka rëndësi. Në qoftë se nuk kemi ne gjyqtarë që të shkojnë të shërbejnë, nuk pranojnë, nuk bëjnë kërkesë, si do të bëhet? Nuk duan të shkojnë, duan të jenë gjyqtarë, ne numrin e gjyqtarëve e kemi të kufizuar, nuk kemi gjyqtarë që janë në pritje dhe t’i thuash atij që je i detyruar që në qoftë se nuk ke vend në gjykatë, je në listëpritje dhe të duhet të shkosh, kjo është një punë shumë e specializuar. Si i bëhet në një rast të tillë? A e kemi menduar këtë ju që e kemi hartuar këtë dispozitë?

**Sokol Sadushi** – Shqetësim është i drejtë. Ne, në fakt, jemi prirur nga ideja që emërimi nga gjyqtar në këshilltar të Gjykatës Kushtetuese është ngritje në karrierë, sepse,

në fakt kështu kuptohet në çdo vend të botës dhe kështu duhet të kuptohet edhe në rastin konkret, sepse ligji “Për statusin e gjyqtarit” e jep këtë lloj qasjeje. Duke menduar se emërimi si këshilltar në Gjykatën Kushtetuese është ngritje në karrierë, është vlerësim, mendojmë që numri i personave që do të konkurrojnë për t’u bërë këshilltar nuk do të jetë i pakët, të paktën këtë gjykojmë dhe nuk besojmë se do të ndodhë ndonjë lloj bllokazhi që të mos ketë gjyqtarë që dëshirojnë të bëjnë karrierë duke u promovuar si këshilltar në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, e kemi parë të arsyeshme që ata do ta dëshironin që të ishin këshilltar dhe gjyqtar kushtetues, sepse është një CV mjaft e mirë në karrierën e tyre për të ardhmen.

Në këtë kuptim, kemi gjykuar duke parë edhe përvojën e vende të tjera dhe Shqipëria besoj në këtë linjë do të ecë. Përvoja ka treguar se ata këshilltarë që janë në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, ata që natyrisht kanë qenë këshilltarë të spikatur, e kanë përdorur këtë gjë për të avancuar më tej në karrierën e tyre. Ne nga kjo jemi nisur. Unë, nuk e di se çfarë mund të ndodhë nesër, por të paktën kemi besuar që do të jetë...

**Fatmir Xhafaj** – Pse janë vënë kufizime? Mund të vijnë të gjithë nga radhët e gjyqësorit dhe do të ishte një gjë pozitive, sipas meje, duke i shkuar versionit tuaj, por nuk kemi pse të vëmë as 1/5-t, as 1/10-t, por të themi se në qoftë se ka vende bosh dhe nuk plotësohen, do të plotësohen nga këta. Pra, mund krijohet kjo gjë, sepse ka dy gjëra tani që të jemi në këtë realitetin tonë.

E para, ne e kemi të përputhur numrin e gjyqtarëve që nxjerrim nga Shkolla e Magjistraturës me kërkesat që kemi. E kemi sot, kështu funksionon sot. Kjo do të thotë se nëse Shqipërisë i duhen 300 gjyqtarë, aq përgatit, 300 gjyqtarë. Kjo do të thotë se në qoftë se këta 10 gjyqtarë duhet të ikin nga kjo 300-a, do të lënë vendet bosh diku, do të cenohet dhënia e drejtësisë, shërbimi në gjykatën iks apo ipsilon ku do të kryhet ky transferim për këtë shkallë.

E dyta, mund të jetë njeri vërtet shumë i mirë në gjykatën ku punon, por nuk plotësohen kriteret për të qenë këshilltar dhe kjo mund të jetë një arsye tjetër, edhe pasja e kriterëve specifike për këshilltarin e Gjykatës Kushtetuese. Në fund fare mund të ndodhë që bëhet shpallja, bëhet kërkesa dhe ata nuk vijnë. Si do të bëni? Ne e kemi

menduar edhe kur kemi bërë formulime kushtetuese se si do të jetë zhblllokimi i situatës.  
Cili është në këtë rast?

**Fatmir Xhafaj** - Po.

**Aurela Anastasi** – Zoti Xhafaj, faleminderit për mundësinë!

Unë doja të sqaroja diçka. Këtu shikohet një konceptim i ri i këshilltarëve ligjorë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Aurela Anastasi** – Problemi që ju shtroni është ai i emergjencës dhe i dispozitave se si do të zgjidhet tani. Çështja më kryesore është a do ta pranojmë ne këtë sistem që kemi për këshilltarët ligjorë apo do të pranojmë një sistem të ri ku këshilltarët ligjorë do të kenë status, do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë dhe këta do të lëvizin brenda sistemit dhe përshtatja e kërkesave për magjistraturën, do të vijë në lidhje me këta? Kështu që unë mendoj ta ndajmë në dy pjesë.

E para, të pranojmë nëse do të kemi këshilltarët ligjorë, gjyqtarë dhe prokurorë që do të jenë brenda sistemit, kjo sepse sot i kemi konceptuar krejt ndryshe. Ne sot kryesisht i kemi njerëz të ditur, mundësisht të rinj që kanë përfunduar studimet jashtë dhe që dinë gjuhë të huaja. Këtë aset kemi sot. Po, tani ne duhet të marrim një vendim shumë të rëndësishëm, ata duhet të jenë pjesë e sistemit, kanë të njëjtat kritere, kanë të njëjtin kontroll, u kërkohen të njëjtat trajnime, do të kalojnë në të gjithë sistemin njëjloj si gjyqtarët dhe prokurorët.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Urdhëro!

Do të ketë status gjyqtari, prandaj mendoj që ta ndajmë në dy pjesë.

E para: A do e pranojmë këtë gjë dhe ta votojmë këtë gjë?

E dyta: Si do të procedojmë, sepse është e vërtetë që po bëjmë një kalim shumë të rëndësishëm, duket si pak e rëndësishme, por në fakt është një pjesë shumë e rëndësishme e reformës dhe si do ta zgjidhim në këta vjet, sepse mund të na vijë ky problemi që ju me shumë të drejtë e ngritët.

Këtë doja të sqaroja.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Deville.

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Unë mendoj se e vetmja fjali për të cilën kemi nevojë në pikën 2 duhet të jetë njësia e shërbimit ligjor të gjyqtarëve dhe prokurorëve të emëruar. Të gjithë të tjerat, 2, 3, 4, 5 dhe 6 duhet të hiqen sepse përsëri kjo përbën një shembull tjetër ku qëllimet e reformës nuk janë marrë aq seriozisht sa duhet. Ajo që kemi këtu në tekstin aktual është që ata duhet të jenë juristë të cilët i plotësojnë kushtet për t'u bërë gjyqtarë. Çfarë do të thotë kjo? Jeni një gjyqtar, apo prokuror e atëherë ju kualifikoheni nga Shkolla e Magjistraturës duke dhënë provimin e hyrjes dhe e keni edhe përvojën praktike, me dhënien e provimit përfundimtar, atëherë kualifikoheni. Edhe një herë, sistemi këtu nuk përmban rotacion. Në këtë mënyrë ne krijojmë një grup mjaft të qëndrueshëm njerëzish që mund të rrinë aty gjithmonë. Jo! Ju nuk duhet ta bëni një gjë të tillë! Duhet të ketë rotacion. Ne i vëmë ata përmes një procesi kontrolli për arsye mjaft të mira, me qëllim që më pas ata të kualifikohen për të qenë gjyqtarë e prokurorë. Nëse hidhni një sy tani, besoj që kryetari i gjykatës dhe jo Presidenti i Shtetit mund të vendosë t'i verë ata atje. Kështu që, unë tashmë po i shoh që po vijnë edhe kushërinjtë. Ju vazhdoni me këtë sistem të vjetër. Dikush bën një favor dhe sjell dikë tjetër. Nuk duhet të jetë Presidenti i Shtetit, duhet të jetë Këshilli ai që ndërmerr një vendim karriere dhe që zgjedh kandidatët më të mirë duke pasur parasysh të gjitha këto kritere për të arritur aty. Më pas, pasi ky person ka qenë aty për një periudhë kohore, kalojmë në fazën tjetër të zhvillimit të karrierës. Kjo është edhe praktika më e mirë evropiane dhe është e pamundur të shmangët procesi i verifikimit me anë të këtyre dispozitave. Kjo është diçka mjaft e keqe dhe nuk duhet ta bëni, sepse më pas do të merrni komenete edhe më të këqija. Fjalja e vetme duhet të jetë “njësia e shërbimit ligjor do të përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë të emëruar” dhe me anë të kësaj ne e kemi në funksionim të gjithë procesin. Kemi rotacionin për një periudhë kohore, kualifikimin e njerëzve, Këshillin që vendos , dhe gjithçka është në vendin ku duhet të jetë, që do të thotë edhe një sistem i çliruar nga korrupsioni.

**Fatmir Xhafaj** – Unë bie dakord me ndërhyrjen tuaj shumë të drejtë, edhe me përcaktimin që bëri zonja Anastasi që ky është një novitet që sjell ky projektligj dhe që ka nevojë të mbështetet. Por, midis novitetit që sillni ju, për qëllimet e larta që kërkon ta fusni këtë në funksion të cilësisë së punës në gjykatë, në funksion të cilësisë së shërbimit që ofron stafi i gjyqtarëve, do të na duhet të kemi një përputhje midis asaj që do të kemi

nevojë në vite dhe asaj që kemi në realitet sot. Do t'ju lutesha për këtë gjë dhe do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që ta rishihni me këtë sy dhe ne nuk jemi kundër. Në parim, me sa unë kuptoj, të gjithë kolegët janë dakord, thjesht na duhet që të bëjmë një përputhje midis kohës, midis realitetit që kemi sot dhe qëllimit shumë të lartë, shumë pozitiv që ju keni kërkuar të fusni. Besoj se do të jetë e njëjta gjë edhe kur të vijë Gjykata e Lartë, kam përshtypjen, i njëjti standard, sepse nuk ka se si të ketë dy standarde.

Do t'ju lutesha dhe do të kërkoja mirëkuptimin e zotit Deville, por edhe të zotit Sadushi, të zonjës Anastasi dhe të ekipeve të tyre, si dhe të zonjës Vorpsi pa dyshim, që së bashku ta rishikoni edhe një herë këtë dhe në qoftë se ju e gjeni me vend, pasi ta bëni këtë analizë që ne ngremë, në rregull ne nuk kemi ndonjë gjë. Ju lutem, ta bëjmë këtë debat, prandaj do të kërkoja mirëkuptimin që për këtë nen t'i jepni ju kohë vetes, t'i japim edhe ne pak kohë vetes që ta bëjmë me kujdes.

Siç e thashë, edhe një herë në princip ne e mbështesim këtë risi, është një hap i mirë, pozitiv përpara dhe këtë e theksoi relatori në fjalën e tij, e theksoi edhe më pas zonja Hysi. Pra, ne si ligjvënës e mbështesim idenë tuaj shumë racionale me interes për cilësinë e punës në gjykatë, por shqetësimi ynë është shumë praktik, do dëshironim që t'i përputhnim këto. Mund të mos jetë me vend, por na siguroni, na bindni që nuk është me vend, por, ju lutem, merrni ju kohën e mjaftueshme, të marrim edhe ne kohën e mjaftueshme që të jemi të bindur në këtë gjë.

Në rregull.

Atëherë, mbetet pezull neni 23 për ta rishqyrtuar mbi bazën e ndërhyrjeve që u bënë.

Vazhdojmë me nenin 24.

Dakord?

Neni 25 “Papajtueshmëria”. Po.

**Vasilika Hysi** – Sugjeroj që në nenin 25 të reflektohen ndryshimet që bëmë në projektkushtetutë, ku është hequr fjala “artistik” dhe kjo kuptohet që është reflektim i teknikës legjislativë, ndërkohë që kam një pyetje lidhur me masën e shpërblimit. Ju thoni që kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohet me vendim të mbledhjes së gjyqtarëve. Unë nuk arrij të kuptoj se si mbledhja e gjyqtarëve mund të përcaktojë masën e shpërblimit për mësimdhënien apo të



ardhurat që merr një gjyqtar nga botimi i një libri. Pra, zoti Sadushi, nëse një gjyqtar boton një libër, a mundet mbledhja e gjyqtarëve të thotë se nga libri ti do marrësh kaq lekë dhe jo më shumë ose në qoftë se ti do të japësh mësim të lejohet të paguhesh me 10 lekë dhe jo me 12 lekë? Pra, ndoshta ka nevojë për një qartësim.

E dyta, lidhur me paragrafin e dytë të po këtij neni, ju thoni që gjyqtari i sapozgjedhur merr masa për shmangien e çdo situatë papajtueshmërie brenda 10 ditëve nga betimi. Në fakt, afati 10 ditor mund të jetë i mjaftueshëm, por edhe mund të mos jetë. Këtu kam parasysh rastet, siç është debati që ne bëmë në Këshillin e Legjislacionit për deputetët, të cilët, para se të fillojnë ushtrimin e detyrës, kanë pasur detyra dhe kanë filluar procedurat për zgjidhjen e konfliktit që mund të kenë pasur, por disa procedura nuk kanë afate të përcaktuara në ligje të tjera, për shembull, nëse një gjyqtar ka qenë avokat dhe do të bëjë ç’regjistrimin nga QKR-ja, gjithë ky proces minimumi merr 45 ditë kohë. Mos ndoshta duhet thënë që gjyqtari i sapozgjedhur merr masa për fillimin e shmangies së çdo situatë, sepse ju nuk mund ta emëroni gjyqtarin të fillojë nga puna në qoftë se ai nuk bën këtë zgjedhje? Pra, mund të keni një periudhë mbivendosjeje. Ndoshta unë nuk jam e qartë, por nga përvoja që kam ndjekur këtu, mendoj që procedurat janë shumë më të gjata se afatet që vendosim.

**Sokol Sadushi** – Lidhur me pyetjen e parë, “kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si edhe masa e shpërblimit”, në fakt, qëllimi është që mbledhja e gjyqtarëve të përcaktojë një kohëzgjatje, dhe është korrekte që gjyqtarët të dinë nëse do të jenë pedagogë në një universitet, sa orë duhet të bëjnë, sepse mund të pengojnë veprimtarinë e trupës.

Ndoshta termi “masa e shpërblimit” tingëllon keq, sepse duket sikur trupa e gjyqtarëve përcakton sa do të jenë honoraret, por ajo vjen vetvetiu, pasi nga kohëzgjatja përcaktohet edhe masa e shpërblimit. Ndërkohë “masa” mund të hiqet si term dhe ne mund ta riformulojmë atë. Qëllimi është për të përcaktuar kohëzgjatjen që gjyqtarët të mos qëndrojnë si pedagogë më tepër sesa veprimtaria e tyre.

Pika e dytë. Mund të krijohet një problem në pamje të parë, po të kemi parasysh faktin që procedura për përzgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues fillon shumë kohë përpara dhe prezumohet që i ka marrë të gjitha masat që të mos jetë në konflikt papajtueshmërie. Mund të ndodhë, dhe janë ato rastet e menjëhershme, në rast dorëheqje apo në rast

vdekjeje që duhet të veprojë menjëherë dhe koha është e shkurtër. Këtu kemi thënë “merr masat”. Ky term do të thotë që ai i bën të gjitha përpjekjet ashtu si deputeti duhet t’i ketë marrë të gjitha masat përpara se të shpallë vendimin KQZ-ja. Këtu e kemi lidhur me betimin që “gjyqtari i sapozgjedhur duhet të veprojë, të bindë që ai ka bërë maksimumin e mundshëm për të shmangur situatat e papajtueshmërisë. Në qoftë se mund të zgjasim afatin, kjo është çështje tjetër, por marrja e masave nënkupton që ai është i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm për të evituar çdo lloj situatë të konfliktit të interesit ose të papajtueshmërisë. Në qoftë se ju mendoni që mund të zgjatet afati, është çështje ...

**Fatmir Xhafaj-** Miratohet neni 25 me ndryshimet e propozuara.

Neni 26. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Kam një pyetje për të dy kolegët, për zonjën Anastasi dhe për zotin Sadushi.

Ju thoni që shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet në seancë plenare publike ose mbi bazën e dokumenteve. Në çdo rast vendos Kolegji ose mbledhja. Kur vendos kolegji dhe kur vendos mbledhja, se nuk është e qartë?

**Sokol Sadushi** - Në praktikë është e qartë....

**Fatmir Xhafaj-** Ka rregullore gjykate, prandaj thamë që do të bëjmë rregullore.

**Sokol Sadushi** – Edhe pa rregullore është e qartë. Në rastin kur kolegji vendos që çështja do të kalojë në seancë plenare, është ai që vendos nëse do të bëhet me bazë dokumentesh apo seancë plenare, dhe mund të ndodhë që vet mbledhja e gjyqtarëve, janë çështjet e vështira, të vendosë nëse do të kalojë apo jo në seancë plenare. Edhe në këtë rast është mbledhja që vendos nëse do të bëhet mbi bazën e dokumenteve apo jo, pra lidhet gjithmonë me shqyrtimin paraprak të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, që në një rast mund të jetë kolegji, në rastin tjetër mund të jetë mbledhja.

**Vasilika Hysi** – Sugjeroj ta riformulojmë fjalinë, nëse jeni dakord, “në çdo rast kolegji ose mbledhja e gjyqtarëve vendos sipas rregullores që keni”, apo e ka në ligj.

**Aurela Anastasi** – Jo, është fjala kështu: ju e keni shumë të qartë, vetëm ta thërrasim në vëmendje atë që duhet. Ka raste që kolegji i seleksionimit paraprak të kërkesës, nuk arrin unanimitetin për të marrë vendim nëse do ta kalojnë në seancë apo do e kalojnë me moskalim? Vetëm këto raste i kalojnë mbledhjes dhe në këto raste vendos

mbledhja e gjyqtarëve. Sipas rastit, vendos kolegji ose mbledhja e gjyqtarëve. Do ta rregullojmë në një mënyrë të tillë.

**Fatmir Xhafaj** – Ta kemi parasysh që me Gjykatën Kushtetuese që interpreton Kushtetutën, jo më me ligjin e vet. Dakord neni 26.

Neni 27. Dakord.

Neni 28, shfuqizimi i nenit 23 ekzistues. Dakord.

Neni 29 që ndryshon nenin 24?

**Rainer Deville** - (*flet anglisht*) Neni 24: kam dy vërejtje. Së pari, çdo qytetar gëzon të drejtën të shkojë në Gjykatën Kushtetuese pa asnjë avokat dhe paragrafi i dytë është ai paragraf ku ne prezantojmë kriterin që përfaqësuesit ligjorë të jenë aty. Çfarë është kjo? A janë përfaqësuesit ligjorë po ashtu avokatë? Apo a janë ata të specializuar për të bërë specializimin? Nëse është e njëjta gjë, atëherë duhet të përdorim të njëjtin term. Nëse çështja qëndron kështu, nuk flasim fare për kritere objektive. Pra, ç'janë këto kritere? Në fund të fundit, si do të përfundojë e gjitha kjo? Takimi i gjyqtarëve do të ketë disa kritere, dikush duhet të regjistrohet nga dikush në gjykatë e pastaj duhet bërë pagesa për të mbuluar listën, apo çfarë ndodh? Unë mendoj që kjo është aq e paqartë, dhe thjeshtë duhet hequr.

**Fatmir Xhafaj**- Nuk po kuptoj, për cilin nen po flasim?

Një minutë, nuk ju pyeta ju të përkthimit.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, unë kam një pyetje, sepse zoti Rajner e ka kapur drejt në pjesën e parë të fjalisë, ai tha paragraf, por është fjali dhe përdor termin “përfaqësues ligjor”. Në pjesën e dytë thotë “përfaqësues ligjor i specializuar”. Pse keni bërë këtë lloj dallimi?

**Sokol Sadushi** – Këtu është lidhësja “ose”, që tregon se nuk është avokat, por është përfaqësues ligjor, mund të jetë përfaqësues i Këshillit të Ministrave apo i Presidencës ose i Kuvendit që nuk është avokat, por duhet të jetë i specializuar, në këtë kuptim është.

**Fatmir Xhafaj** -Te fjalia e parë “nuk është përfaqësues ligjor i specializuar”, te fjalia e dytë “është i specializuar”. Ku ndryshon nga fjalia e parë në fjalinë e dytë, si u bë “i specializuar”?

**Sokol Sadushi** – Në fakt, në fjalinë e parë kemi pasur parasysh avokatët. “Ose” është një term i përgjithshëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj**- Atëherë sqarojeni këtë.

Dakord? Miratohet!

Faleminderit, zoti Devil!

Neni 30.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, unë kam një pyetje lidhur me paragrafin e dytë, fjalinë e fundit. Ju thoni që “forma e plotë e vendimit publikohet brenda një afati të arsyeshëm”. Pse përdorni termin “formë” dhe nuk thoni “vendimi i plotë”?

E dyta, përse nuk përcaktoni një afat, por e lini “një afat të arsyeshëm”?

**Sokol Sadushi** – Keni shumë të drejtë! Këtë gjë e kemi shënuar, sepse e kemi përcaktuar afatin në disa dispozita të tjera, që është neni 83, neni 89, keni shumë të drejtë, këtu është harruar dhe ndërkohë do të saktësojmë dhe termin “forma e plotë e vendimit”.

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, jemi te neni 30. Dakord, meqenëse i bëmë edhe nenin 30 edhe nenin 31, nuk keni gjë tjetër për nenin 31? Dakord.

Faleminderit!

Neni 32. Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me paragrafi e pestë, sugjeroj të kemi një riformulim, pasi nuk del e qartë. Do të sugjeroja një riformulim, nëse më lejoni, ta lexoj: “kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave”.

“Drejtoria gjyqësore i kthen kërkuarit kërkesën për të bërë plotësimet brenda një afati 10-ditor”.

“Në rast se kërkuari nuk e paraqet kërkesën e plotësuar ose brenda afatit të caktuar, kërkesa arkivohet nga drejtoria”.

**Sokol Sadushi** – Jemi plotësisht dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ju pata paralajmëruar që nuk jemi komision që i kalojmë lehtë gjërat. Te neni 32, pika 6.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, pse kërkesa e regjistruar i dorëzohet kryetarit të gjykatës dhe pse i lini caktimin e relatorit këshilltarit ligjor të kryetarit të gjykatës? E bëj këtë pyetje edhe për ta lënë si rekord këtu, për të ditur pse kryetari i gjykatës do të marrë kërkesa, duhet të bëjë caktimin e relatorit, të këshilltarit që përgatit çështjen për shqyrtim?

**Sokol Sadushi** – Në qoftë se do t’ia hiqnim edhe këtë kompetencë kryetarit, besoj se zoti Rajner nuk do të kishte më probleme lidhur me rizgjedhjen e tij, sepse është e vetmja kompetencë që ai ka, të gjitha të tjerat i ka trupa.

Janë dy praktika në të gjithë gjykatat Kushtetuese: njëra që caktohet me short çështja dhe një që e cakton kryetari. Këtu është menduar ajo traditë që ne kemi.

**Fatmir Xhafaj** - Pse jo me short, sepse kryetari mund të dijë aftësinë hipotetike/shpirtërore me palën dhe thotë *okej*. S’ka nevojë fare t’i ndërhyjë, sepse e merr me mend ai çfarë duhet të bëjë si relator.

**Sokol Sadushi** – Kjo është e vërtetë, duket e lehtë si çështje, por bëhet delikate kur praktika ka sjellë problematika në drejtim të caktimit të çështjes që bën kryetari për relatorin, sepse duket sikur është subjektivizëm i theksuar. Ka argument pro, përse duhet të jetë kështu, të paktën për përvojën që ka pasur dhe ka Gjykata Kushtetuese që përgjithësisht kryetari ia përcjell çështjen atij gjyqtari që ka një drejtim të specializuar dhe çështja ndoshta mund të kërkojë një drejtim të specializuar. Ndoshta me ndryshimet që janë bërë në ligj, ku përcaktohet njësisia e shërbimit ligjor, që do të jetë një trupë e tërë, mund të duket që është një dispozitë e tepërt. Ne nuk insistojmë që duhet patjetër t’i caktojë kryetari. Nëse do t’i vlejë argumentit që thamë pak më parë lidhur me rizgjedhjen, atëherë vendosni shortin që shkon më në logjikë, por, edhe në qoftë se do ta vendosni nga kryetari, nuk është element i theksuar korruptiv, sepse trupa e gjykatës, ngaqë vepron me 9 anëtarë, është pak e vështirë që të ndikojë një gjyqtar. Ne e kemi ruajtur këtë traditë për shkak të ligjit ekzistues, sidoqoftë e lëmë të hapur këtë diskutim dhe vendoseni ju. Ne nuk kemi kundërshtim edhe për zgjidhjen tjetër, sepse edhe shorti është zgjidhje korrekte për çështjen, ashtu si edhe caktimi nga kryetari është çështje përgjegjshmërie.

**Fatmir Xhafaj** - Jam shumë dakord që ai të bëjë një përzgjedhje te këshilltari për shkak se nuk bën sens që këshilltari të hedhë short te këshilltari, se ata, në fund të

fundit, do të përgatisin materialin dhe ka specializime, prirje etj., etj., por gjyqtarët prezumohet që janë gjyqtarë kushtetues dhe janë në barazi ndërmjet tyre, ata që do të jenë nesër, sepse ata që janë sot, mund të flas për orë të tëra për ata që kanë qenë dhe për ata që do të jenë, natyrisht, zoti Sadushi mos u shqetëso.

**Sokol Sadushi** – Zoti kryetar, unë po dal kundër vetes, në fakt, megjithëse kam qenë me këtë dispozitë, por, duke parë gjithë frymën që është vendosur shorti, në përgjithësi janë hequr kompetencat e kryetarit në të gjithë gjyqësorin, edhe në ligjet që do t’u vijnë, besoj që edhe zoti Rajner e ka këtë ide, mundet edhe që ta hiqni kompetencën e kryetarit dhe t’ia lini shortit. Kjo është një çështje që do ta vlerësoni ju. Unë thashë pikëpamjen time.

**Fatmir Xhafaj**- Biem dakord me ndryshimet. Rishikojeni dhe, para se të kalojë në votim në tërësi, së bashku me nenet e tjera, na e sillni vetë formulimin. E lëmë edhe ne në çmimin tuaj që të shihni avantazhet dhe disavantazhet.

Miratohet me ndryshimet neni 32.

Neni 33 “Shpenzimet gjyqësore”.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një kërkesë për paragrafin e parë, nga pikëpamja e teknikës legislative duhet riformuluar, sepse ju thoni: “Procesi gjyqësor para gjykatës u nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për tarifatat gjyqësore””. Kjo është vetëm për shpenzimet gjyqësore, mendoj unë, sepse procesi gjyqësor pranë gjykatës u nënshtrohet rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe rregullores për procedurat që ju keni. Prandaj kjo gjë duhet të dalë e qartë, pavarësisht se në titull thuhet: “Shpenzimet gjyqësore”. Mund të themi që: “Shpenzimet gjyqësore në proceset gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për fushën përkatëse.”

**Fatmir Xhafaj** - Po, sepse duket sikur procesi varet nga tarifa.

**Sokol Sadushi** - Është shumë e saktë si ndërhyrje.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord! A ka diçka tjetër për nenin 33? Nuk ka.

Neni 33 miratohet me ndryshimet.

Neni 34? Dakord!

Neni 35, që ndryshon nenin 31 “Shqyrtimi paraprak i kërkesës”. Jemi dakord!

Neni 36. Pas nenit 31 ekzistues, shtohet neni 31/a “Moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.”

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, kam një shqetësim dhe dua një përgjigje nga kolegët për paragrafin 1 të këtij neni, pasi nuk shoh ndonjë dallim midis fjalisë së parë dhe fjalisë së dytë. Ju thoni: “Kolegji vendos njëzëri për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Mbledhja e gjyqtarëve vendos me shumicën e votave për moskalimin e çështjes në seancë plenare.”

Bazuar në sqarimin që më dhatë më parë, kuptohet se kompetencat janë të ndara, por në mënyrën që thuhet “sipas rastit” këtu nuk është e qartë.

**Sokol Sadushi** - Atëherë, ligji “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe dispozita që sapo kaluam e trajton mënyrën e vendimmarrjes. Këtu bëhet fjalë që kolegji vendos njëzëri, edhe për shkak të unanimitetit që duhet për të vendosur kalimin apo moskalimin, ndërkohë që te mbledhjet e gjyqtarëve nuk mund të jetë ky rregull i unanimitetit, sepse në nëntë anëtarë është e vështirë, ndaj përdoret vendimmarrja me shumicë votash.

Në fakt, kur e lexon ligjin në tërësi, sidomos nenin 31, i cili përcakton mënyrën se si vepron mbledhja e gjyqtarëve dhe kolegji, automatikisht del edhe kuptimi i nenit 31/a. Për mua është shumë e qartë, por nuk e di a është për ju?

**Fatmir Xhafaj** - Jeni dakord me sugjerimin e nenit 36? Dakord!

Neni 37. Pas nenit 31/a, shtohet neni 31/b “Heqja dorë nga kërkesa.” Dakord!

Neni 38. Pas nenit 31/b, shtohet neni 31/c “Abuzimi me të drejtën për të paraqitur kërkesë.”

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, kam një pyetje lidhur me rolin e përfaqësuesit ligjor të kërkuarit.

Në paragrafin 1, thuhet se kur gjykata konstaton se përfaqësuesi ligjor ka fshehur fakte dhe rrethana, pra jo kur i ka shtrembëruar, (në bazë të rregullave që ne kemi në proces dhe të drejtës që ka përfaqësuesi ligjor, i cili nuk mund të dalë përtej kërkesave të palës që përfaqëson) në rast se pala kërkon që këtë fakt të mos e vërë në dukje, a mban përgjegjësi përfaqësuesi ligjor? A mund të kapërcejë përfaqësuesi ligjor detyrën e tij dhe të nxjerrë në pah fakte, që vetë kërkuari, i cili e ka mandatar, nuk kërkon të dalin në pah? Në cilën praktikë e keni gjetur këtë lloj parashikimi?

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

**Arta Vorpsi** - Nëse mundet, dua të bëj një sqarim. Në fakt, në praktikë na ka ndodhur shpesh të kemi kështu rastesh. Ka dy mënyra të dërgimit të kërkesës në gjykatë: ose kërkesa vjen e firmosur nga kërkuesi, ose pavarësisht se kërkesa mund të jetë hartuar nga avokati, mund të vij në gjykatë me firmën e kërkuesit. Ka ndodhur që kur kemi tërhequr një dosje procesit nga një gjykatë rrethi, kemi parë se faktet e parashtruara në kërkesë nuk kanë qenë të vërteta, pra kanë qenë të shtrembëruara.

**Vasilika Hysi** - Çfarë të vërtete fshihnin?

**Arta Vorpsi** – Ka pasur raste kur kërkuesi ka thënë se nuk ka marrë njoftim, ose se nuk ka marrë pjesë në seancë se nuk ka qenë njoftuar, ndërkohë del se ai është i njoftuar. Këto fakte nuk i janë paraqitur gjykatës në kërkesë. Ne mund ta kemi kaluar çështjen edhe në gjykim për shkak të pretendimeve që kërkuesi ka pasur dhe kanë dalë fakte të fshehura, pra nuk janë treguar realisht nga kërkuesi. Nëse kërkuesi, me vullnetin e tij, ka zgjedhur një përfaqësues, përgjegjësine do ta mbajë edhe ai, pavarësisht se kërkesën mund t’ia ketë bërë avokati. Të paktën unë kështu e kuptoj këtë gjë.

**Vasilika Hysi** - Zonja Vorpsi, shpjegimi juaj është shumë i qartë dhe jam absolutisht dakord. Po lidhur me përmbajtjen? Nëse kemi një rast penal, avokati nuk mund të rëndojë pozitën e kërkuesit të tij me fakte që vetë kërkuesi nuk i ka nxjerrë. Për anën procedurale kjo që thoni ju është e drejtë, por në aspektin e provave, të fakteve, të një procesi të rregullt ligjor e të tjerë mua më duket se po i kërkojmë avokatit më shumë se çfarë ka ai për detyrë. Ndoshta këtu kemi nevojë të konsultohemi me standardet europiane lidhur me rolin e avokatit dhe marrëdhëniet e avokatit me klientin, si dhe me praktikën e Gjykatës së Strasburgut.

**Sokol Sadushi** - Me të drejtë ju ndërhytë. Ndoshta do ta rishohim këtë pikë për t’i bërë një riformulim, në mënyrë që sa më korrekt dhe të mos lëmë asnjë nga dyshimet që ngritët ju.

**Rainer Deville** - (*flet anglisht*) Në parim është paditësi ai që duhet gjobitur e nëse përfaqësuesi ligjor bën diçka që është jashtë tagrave të tij, atëherë përfaqësuesi ligjor është përgjegjës përpara klientit. Pra, klienti duhet t’ia kërkojë përgjegjësine përfaqësuesit ligjor. Është po ky sistem ku ne thjeshtë shtojmë sasinë prej 500,00 Lekë e cila i shtohet paditësit e ndoshta mund të themi që përfaqësuesi ligjor ka përgjegjësine për



ndonjë lloj mashtrimi, gjë e cila përputhet edhe me Kodin Civil, dhe me prokurën e përfaqësimit. Në realitetin shqiptar të gjykatave është e vërtetë që avokatët disa herë veprojnë në mënyrë mjaft të pavarur. Po ashtu është mundësia që mund të konsideroni përgjegjës edhe përfaqësuesin ligjor, por Kodi Civil mund të jetë ndryshe. Klienti ka një përfaqësues ligjor e pastaj përfaqësuesi ligjor është përgjegjës përpara klientit. Klienti është palë e çështjes. Kështu që, normalisht ju duhet të shkoni drejt tek përfaqësuesi ligjor.

**Sokol Sadushi** - Ne do ta rishohim këtë dispozitë, se me të vërtetë ka diçka që ndoshta nuk shkon. Kështu, do t'i japim mundësi vetes për ta riparë dhe për ta riformuluar pjesën që lidhet me përgjegjësinë.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull! Neni 38 lihet për t'u parë.

Neni 39? Dakord!

Neni 40?

**Vasilika Hysi** - Kam një sugjerim te paragrafi 2, germa "b", sugjeroj që të themi se kryesuesi i seancës orienton diskutimin mes palëve dhe jo dialogun. Gjithashtu, duhet të heqim fjalën "eviton", se është thjesht teknikë legislative.

Në germën "ç" sugjeroj që duhet të zërë vend tërheqja e vëmendjes, pasi kryetarit i seancës nuk mund t'ia heqë menjëherë të drejtën e fjalës personit për çdolloj kundërshtimi me rregullat e etikës, sepse mund të jetë abuzive. Në këtë mënyrë, po të dojë personi mund të pozicionohet në mënyrë subjektive, që pa iu tërhequr vëmendja të kuptojë se po i tejkalon rregullat e etikës dhe të moralit, pra të këtë një farë proporcionaliteti, nëse më lejoni.

E fundit, lidhur me germën "d" ju thoni: "Kryesuesi i seancës plenare ushtron këto detyra: d) kur ata nuk zbatojnë urdhërimet e kryesuesit të seancës, si dhe kur nuk tregojnë respekt për trupin gjykues dhe Kushtetutën". Mos ndoshta këtu gjatë zbardhjes mungon ndonjë fjalë, ndonjë germë apo ndonjë togfjalësh?

**Rainer Deville** - *(flet anglisht)* Lidhur me ndërprerjen dhe zgjerimin e debatit, e kam fjalën për një gjyqtar që po bën praktikën e që ndonjëherë merr pjesë edhe në panel. Ne i ndërpresim njerëzit dhe ndonjëherë duhet bërë një gjë e tillë. Kështu që, do të sugjeroja që ajo që shohim këtu është në rregull dhe bie dakort që drafti është në rregull. Pyetja që kam unë lidhet me pikën 4 të fjalisë 2, aty ku duhet rregulluar që gjykata do të

bëjë një pushim nëse është e nevojshme - kjo më duket paksa qesharake. Kjo është një praktikë standarte gjyqësore, a ka nevojë që të shkruhet në ligj?! Unë mendoj se duket pak qesharake. Nëse kemi vertetë nevojë ta rregullojmë këtë gjë me anë të ligjit, atëherë ndoshta nuk është mjaft bindëse për Bashkimin Evropian e ndoshta mund të hiqni fjalinë e parë në pikën 4. Por pjesa tjetër është thjeshtë praktikë gjyqësore.

**Fatmir Xhafaj** - Lidhur me germën ‘d’ që thotë zonja Hysi, është e pambyllur si fjali, sepse këtu thuhet: “Kryesuesi i seancës plenare ushtron këto detyra: d) kur ata nuk zbatojnë urdhërimet e kryesuesit të seancës, si dhe kur nuk tregojnë respekt për trupin gjykues dhe Kushtetutën”. Për çfarë detyre bëhet fjalë?

**Sokol Sadushi** - Është e drejtë dhe, në fakt, kjo nuk ka lidhje me pikën 2, por ka lidhje me pikën 3.

**Fatmir Xhafaj** - Kurse për pikën 4 ka të drejtë, se mund të përmblihet me një fjali vetëm kur e çmon vetë, pa hyrë në hollësi.

**Aurela Anastasi** - Te pika 4 jemi përpjekur të japim idenë e seancës pa ndërprerë si rregull, por e shkurtojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, jemi dakord me nenin 40, me ndryshimet.

Neni 41?

**Vasilika Hysi** - Te neni 41 kam një shqetësim, që e kam shprehur edhe më parë. Në paragrafin 4 lënia e termit “një afat i arsyeshëm” mendoj se nuk është e qartë. Në qoftë se vazhdojmë me logjikën, që ju me të drejtë e thatë se duhen vënë disa afate, kjo do të ishte mirë, sepse nuk mund t’ia lëmë në dorë gjyqtarit që brenda një afati të arsyeshëm ai të paraqesë kërkesën me shkrim për heqjen dorë nga çështja. Për shembull, gjyqtari nuk dëshiron që ta paraqesë kërkesën me shkrim për heqjen dorë nga çështja dhe e lë një muaj, dy muaj, tre muaj apo katër muaj.

**Sokol Sadushi** - Është e drejtë, por në qoftë se nuk do gjyqtari, atëherë vepron rregull i procedimit disiplinor. Në qoftë se kanë qenë kushtet për heqjen dorë nga çështja dhe ai nuk ka hequr dorë, atëherë ndaj tij fillohet procesi disiplinor, por brenda një afati të arsyeshëm normalisht edhe mund të heqë. Nuk mund të mendojë gjyqtari që nuk heq dorë, sepse nëse do të kuptohet se ai ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë, ai do të mbajë përgjegjësi disiplinore.

**Vasilika Hysi** - Po këtu, zoti kryetar, mendoj se mbledhja e gjyqtarëve vendos ose jo pranimin e saj brenda një afati të përcaktuar ose në rregullore, si e keni, sepse nuk mund të thoni “për pranimin ose jo të saj”. A duhet të ketë mbledhje e gjyqtarëve një afat prej sa ditësh duhet të vendosë? A e pranon apo jo dorëheqjen?

**Sokol Sadushi** - Nuk vepron ky rregull, sepse vetë gjykata është e interesuar që çështjen ta zhvillojë në kohën e arsyeshme dhe afati është i prezumuar brenda kohës që ajo vendos. Kështu, nuk mund t’i thuash gjyqtarit vendose brenda kësaj kohe, e rëndësishme është të vendosë para se të thirret në seancë gjyqësore.

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Ndoshta mund të themi “pa pasur vonesa”. Nuk keni nevojë të vini një periudhë kohore specifike, por mund të thoni që duhet bërë menjëherë. Po ashtu, pika 4 duhet të jetë pika 3.

**Fatmir Xhafaj** - Atëherë, dakord me numërtimin dhe me propozimin për ndryshim, kështu që riformulojeni edhe një herë.

Neni 42?

**Vasilika Hysi** - Lidhur me nenin 44, paragrafin 1, fjala “si rregull” mendoj se është e tepërt, por duhet thënë: “Brenda 30 ditëve para datës së caktuar për zhvillimin e seancës”, sepse vazhdimi i fjalisë më pas e parashikon edhe mundësinë që të ketë përjashtim nga rasti kur vendoset ndryshe, por kur duhet thënë se për cilat raste vendoset ndryshe. Duhet të ketë disa arsye në ligj që Gjykata Kushtetuese mund të përjashtojë, përndryshe do të bëhet subjektive.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull, dakord me propozimin e paraqitur për ndryshim.

Neni 43? Dakord!

Neni 44? Dakord!

Neni 45? Dakord!

Neni 46? Po, keni diçka për të shtuar?

**Rainer Deville** - *(flet anglisht)* A mund t’i hedh edhe një sy Nenit 43/a? Përsëri mendoj që nëse i hidhni një sy paragrafëve 2 dhe 3, kjo është pak si shumë për legjislacionin. Ne po flasim për traditën nëpër gjykata dhe sigurisht që kjo respektohet, por kjo gjë me të vërtetë duhet rregulluar me ligj. Ne një herë kemi pasur një rast terrorizmi në Gjermani, ku kryetari i gjykatës erdhi dhe i kërkoi terroristit të ngrihej në këmbë. Pastaj terroristi u përgjigj që nëse një gjë e tillë i shërben drejtësisë unë do të

ngrihem në këmbë kur të hyni ju dhe ky u bë një citat mjaft i famshëm. Ndoshta ju mendoni që nëse kjo gjë është e nevojshme, kjo varet nga ju. Ky është vetëm nje koment.

**Sokol Sadushi** – Nuk është korrekte. Në fakt, është vendosur, por kjo duhet të zërë vend në rregulloren procedurale të gjykatës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, mund të jetë e përmbledhur për të katër pikat.

Neni 44 u miratua me ndryshimet.

Neni 45.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje te neni 45: në nenin 47 ju përcaktoni të drejtën e gjykatës që t'i drejtohet Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe të ketë një *amicus-curial*. Është shumë e drejtë, sepse përputhet edhe me rolin që ka marrë Gjykata Europiane. Po vetëkërkuesi a ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës që të ketë një mendim të tillë? Po, t'ia kërkojë gjykatës dhe gjykata të vendosë, por a ka të drejtë kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij ta kërkojë një gjë të tillë? Pse të mos parashikohet kjo te paragrafi 2 i nenit ...

**Fatmir Xhafaj** – Ti ke thënë: “Të paraqesin kërkesa para Gjykatës Kushtetuese”, apo jo?

**Vasilika Hysi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Aty përfshihen të gjitha, kërkesë është ajo.

**Vasilika Hysi** – Jo, kërkesa është vetëm për shtim ose pakësim të objektit, ose heqjen dorë nga kërkesa.

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, “Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit pranë gjykatës kanë këto të drejta”, dhe vazhdon: “d”: “Të paraqesin kërkesat para Gjykatës Kushtetuese” dhe pikë.

**Vasilika Hysi** – Dakord, por përfshirë edhe këto kërkesa.

**Fatmir Xhafaj** – Kur të shkojë te neni përkatës. I përthith ajo.

*(Diskutime pa mikrofon).*

Neni 45 miratohet.

Neni 46. Dakord.

**Rainer Deville** - *(flet anglisht)* Kritika ndaj Gjykatës Kushtetuese është se ata vendosin diçka dhe arsyetimi nuk jepet brenda kohës së caktuar. Ne nuk kemi ndonjë nen që thotë që ky përbën një përjashtim, pasi Gjykata Kushtetuese merr vendimin e pastaj ky

vendim bëhet i vlefshëm në formë të shkruar dhe i jepet menjëherë publikut. Ky është edhe standarti ndërkombëtar. Do të prisja që këto dispozita të seancës dëgjimore, procesverbali dhe fjalët e përzgjedhura nga Gjykata Kushtetuese të jenë të tilla që të ftojnë palën në momentin kur publikohet apo jepet vendimi, ky i fundit të jetë në formë të shkruar, i nënshkruar dhe i botuar. Mund ta bashkojmë këtë me Nenin 83.

Mbajeni shënim!

**Sokol Sadushi** – Më falni, arsyetimi i vendimit të gjykatës ka gjetur vend në tre dispozita. Flitet në përgjithësi edhe kur flitet për vendimin e gjykatës, që duhet të jetë i arsyetuar, neni 83, pika 6...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, kur të shkojmë te neni 83 do ta ... Edhe unë e mbështes propozimin e zotit Rajner.

Neni 46 dakord.

Neni 47 “Pezullimi i gjykimit”. Dakord.

Neni 48 “Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çdo rast jepet i arsyetuar dhe publikohet menjëherë”, dakord.

Neni 49, dakord.

Neni 50 “Afati i shqyrtimit të çështjes”. Dakord.

Neni 51, që ndryshon nenin 49 “Subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** – Duhet të kemi parasysh propozimin e relatorit Majko te germa “ç” në ligj, ku nuk kemi përmendur asnjëherë ç’është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Formulimet duhet të jenë të plota.

**Aurela Anastasi** – Do të vëmë emrat e plotë, normalisht.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Rainer Deville** - *(flet anglisht)* Aty nuk kemi ndonjë mospërputhje, kështu që çështja standarte duhet të jetë që vendimi i formës së prerë të shpallet menjëherë. Unë mendoj që ky është njëri prej problemeve lidhur me perceptimin e Gjykatës Kushtetuese.

Dakord me nenin 51 me sugjerimet që u bënë.

Neni 52.

**Vasilika Hysi** – Kam një pyetje, zoti Sadushi, për paragrafin e parë: ju thoni se kërkesa në gjykatë për papajtueshmëri mund të paraqitet brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e aktit. Pse nuk e lidhni me momentin kur konstatohet?

**Fatmir Xhafaj** – Ai mund të rrijë gjithë jetën dhe të thotë...

**Vasilika Hysi** – Jo, u konstatua tani që akti ka hyrë në fuqi dhe ka një papajtueshmëri.

**Fatmir Xhafaj** – Akti ka hyrë në vitin 2000 dhe ai kujtohet në vitin 2025 dhe thotë: unë tani e mora vesh.

**Sokol Sadushi** – Ka një arsye shumë të fortë, që këtu kemi të bëjmë me gjykimin abstrakt dhe institucionet publike prezumohen se e dinë ligjin, është ndryshe nga individi dhe në këtë rast lidhet me hyrjen në fuqi.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 52.

Neni 53. Dakord.

Neni 54. Dakord.

Neni 55.

I keni parë mirë geramat nga lëvizjet, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Jo, kam merak, sepse ka lëvizur drafti. Para votimit në tërësi duhet riparë edhe një herë me kujdes.

Neni 56 “Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Neni 57. Dakord.

Neni 58. Dakord.

Neni 59. Dakord.

Neni 60. Dakord.

Neni 61. Dakord.

Neni 62.

**Vasilika Hysi** – Te neni 62 mendoj që fjalia e parë të ketë një riformulim nga pikëpamja e teknikës legjislativë dhe të lexohet: “Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e anëtarëve të saj në rastet e kalimit të çështjes në seancë plenare”.

**Sokol Sadushi** – Normalisht, ajo nuk lidhet vetëm me seancën plenare, lidhet edhe me gjykimin me dokumente, që do të vendosin me shumicën e votave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Vasilika Hysi** – Paragrafi i parë i këtij neni ka nevojë të shqipërohet, të riformulohet nga ana e drejtshkrimit, me qëllim që të dalë e qartë.

*(Diskutime pa mikrofon).*

**Sokol Sadushi** – Këtu bëhet fjalë për shkarkimin e Presidentit, është dispozitë e veçantë dhe duket sikur ka të bëjë me të gjitha rastet e tjera, por është vetëm për rastin e shkarkimit të Presidentit dhe nuk duhet të vendoset në shqyrtimin normal, por nga e gjithë trupa dhe bëhet në seancë publike, nuk bëhet mbi bazë dokumentesh, sepse ka një diferencë, shpjegohet edhe në pikën e dytë.

**Vasilika Hysi** – Nuk jam për përmbajtjen, jam për mënyrën e renditjes së fjalëve, për formulimin. Përmbajtja është në rregull.

**Sokol Sadushi** – Jo, është për t'i dhënë kuptim që te pika e parë. Fjalja e dytë është që asnjëherë nuk zhvillohet mbi bazë dokumentesh, po e interpretoj. Në qoftë se bëhet fjalë për shkarkimin e Presidentit, do të vendoset nga shumica e trupës, do të kalojë në seancë plenare dhe do të bëhet gjyq publik, jo gjyq mbi dokumente, sepse nuk mund të bëhet për këtë rast. Prandaj është thënë kjo, është më tepër për t'i dhënë një karakter këtij procesi.

**Fatmir Xhafaj** – Qartë, për të mos pasur keqkuptime nesër, që e shkarkoi me dyer të mbyllura. Larg qoftë!

**Vasilika Hysi** – Po Presidenti mund të jetë i pranishëm?

**Sokol Sadushi** – E thotë pika e dytë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 63 “Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** – Te paragrafi i katërt i nenit 63 më duken të tepërta fjalët e përdorura: “nuk përfiton asnjë nga trajtimet e veçanta”. Sugjeroj të formulohet dhe të thuhet: “Kur vendoset deklarimi i shkarkimit nga detyra e Presidentit të Republikës, ai nuk përfiton nga trajtimet e veçanta të parashikuara për funksionarët e lartë”. Kur thua “asnjë”, fjala “trajtimet” i përfshin të gjitha.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe fjalët “ai nuk përfiton trajtimet e veçanta”.

Dakord, miratohet me ndryshimin.

Neni 64. Dakord.

Neni 65. Dakord.

Neni 66 “Subjektet kërkuese”. Dakord.

Neni 67. “Afatet e kërkesës”. Shtohet neni 66/a. Dakord.

Neni 68. Shtohet neni i titullit me përmbajtjen: “Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Neni 69. Dakord.

Pas nenit 67 shtohet neni 67/a me këtë përmbajtje: “Subjektet kërkuese”, dakord.

Neni 69, që shtohet neni 67/b, “Shqyrtimi i çështjes”.

**Sokol Sadushi** – Ka një gabim, zoti kryetar. Neni 69 është dy herë, duhet të vini nenin 70.

**Fatmir Xhafaj** – Po, keni të drejtë.

Neni 70, që bëhet neni 71, sipas Artës.

Neni 70, që bëhet 71.

Shtohet 67/c, “Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Nenet 71 dhe 72, dhe kështu do të vazhdojmë me të gjitha për rinumërtimet për shkak të ndërhyrjeve që do të bëhen.

Shtohet titulli “Procedura për verifikimin e rezultateve të referendumit”.

Pas nenit 67/c shtohet neni 67/ç “Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

**Vasilika Hysi** – Te paragrafi i dytë, ku gjykata të lejohet të bëjë shtyrjen e afatit, mund të themi “jo më shumë se 1 muaj”, jo “deri në një muaj”. Aurela është më e saktë në këtë terminologji.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin.

**Pandeli Majko** – Zonja Aurela, mos është më mirë t’i vëmë me ditë, për shembull, 30 ditë dhe jemi në rregull? Sepse ndonjëherë ngatërrohemi me punën e muajit, varet cili muaj i bie.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 72, që bëhet 73.

Shtohet 67/d. Dakord.

Neni 73, që shton 67/dh për vendimmarrjen. Dakord.



Neni 74, shtohet titulli i nenit me përmbajtje: “Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Neni 75, shtohet titulli i nenit me përmbajtje: “Shqyrtimi i çështjes”, dakord.

76-a. Neni 70 “Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** – Te paragrafi i dytë, shprehja “kur çështja e sjellë nga Gjykata e Lartë”, mos është “kur çështja e paraqitur”? Sepse nuk e ka sjellë dorazi, e ka paraqitur zyrtarisht, apo jo?

**Sokol Sadushi** – Do ta korrigjojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin.

Neni 77 “Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual”. Shtohet titulli me këtë përmbajtje dhe më pas shtohet neni 71 “E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual”. Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord, do t’i pastrojnë vetë.

Neni 78, ku shtohet 70/a “Kriteret për të ushtruar”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Neni 70 apo neni 71/a?

Neni 70? E keni bërë që shtohet neni 71/a?

**Vasilika Hysi** – Jo, mund të shtohet edhe 70/a?

**Sokol Sadushi** – Meqenëse është neni 71 përpara, në logjikë është 71/a, është gabim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual.

**Vasilika Hysi** – Në paragrafin e parë, te germa “a”, unë do të sugjeroja që te fjalët “kuadri ligjor i brendshëm” të themi “legjislacion i brendshëm”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, miratohet me sugjerimin.

Neni 79, që shton nenin 71/b me shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese, dakord.

Neni 80, që shton nenin 71/c me titullin: “Detyrimet që rrjedhin nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Neni 81, që shton nenin 71/ç, me titull “Shqyrtimi i kërkesave për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese”. Dakord.

Neni 82, që shton 71/d-në me titull “Shqyrtimi i kërkesave sipas nenit 179/a të Kushtetutës”. Dakord.

Neni 83, që ndryshon paragrafin e 6-të të nenit 72.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Te neni 82, ne i referohemi një ligji, i cili ka një afat se për sa kohë do të zbatohet. Pra, ne i referohemi ligjit numër 138 të vitit 2015. A mos do të ishte më mirë të shmangnim numrat e ligjeve dhe të themi: “Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të jo më pak se 1/5-ës së deputetëve të Kuvendit, shqyrton rastet e parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”” apo duhet thënë patjetër 179/a dhe...?

**Fatmir Xhafaj** – Ka të drejtë, sepse këtu mund të ndryshohet vetë ai ligj.

**Sokol Sadushi** – Kështu është në të gjitha ligjet e tjera. Sa herë që vendoset ligji, do të vendoset numri dhe data. Ato mund të ndryshojnë dhe le të ndryshojë përsëri ky ligj, por neni 179/a do t’i referohesh, po ashtu edhe ligjit me numër dhe me datë do t’i referohemi.

**Vasilika Hysi** – Zoti Sadushi, ne po flasim për një ligj me shumicë të cilësuar këtu dhe ndërhyrjet në ligjet me shumicë të cilësuar nuk janë aq të lehta. Nga ana tjetër, në Komisionin e Ligjeve, ne kemi vendosur një praktikë që të shmangim numrat e ligjeve, sepse ndodh që një ligj të shfuqizohet dhe të miratohet një ligj tjetër. Në këtë rast do të jemi shumë të vëmendshëm që të gjitha ligjet që janë në ndikimin e këtij ligji, të rishikohen. Deri më sot, të paktën me praktikën, me përvojën që ne kemi këtu, unë nuk kam parë që pasi të kemi ndryshuar një ligj, të kenë ndryshuar të gjitha ligjet e tjera. Ne sot shohim në Komisionin Ligjeve, për shembull, që kemi një ligj të ri, në një fushë të caktuar, por ligjet vazhdojnë t’u referohen ligjeve të vjetra. Qytetarët nuk kanë aq kulturë sa ta bëjnë precedent dhe të thonë: i referosh një ligji të shfuqizuar, sepse nuk janë kaq të vëmendshëm, por, të paktën, ne si ligjvënës duhet të jemi të kujdesshëm. A ka ndonjë rast tjetër, kur Gjykata Kushtetuese shqyrton kërkesat e ligjit numër 138 të vitit 2015, përveçse në rastet kur janë thënë laksative?

**Sokol Sadushi** - Për t’iu referuar numrit dhe datës së ligjit është domosdoshmëri, sepse është shumë e rëndësishme, më tepër për gjykatat më pas, sepse në qoftë se do t’i referohemi ligjit për kthimin e pronave, pa thënë numër dhe datë, nuk

dimë se cilit prej ligjeve do t'i referohemi, por, meqenëse po insistoni nëse themi neni 179/a i Kushtetutës, e kemi thënë edhe ligjin për dekriminalizimin.

Nuk besoj se përbën problem kjo gjë, por duhet saktësisht numri dhe data e ligjit në çdo ligj.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 83? Dakord.

Neni 84? Dakord.

**Rainer Deville** *-(flet anglisht)* Ky është neni im, dhe më duhet të ndërhy këtu. Kjo ka të bëjë me perceptimin e publikut dhe eficcencën e sistemit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese është një ndër organet kyce dhe sot ne hasemi me kritikën që ata marrin vendimin dhe arsyetimi nuk vihet në dispozicion menjëherë. Dëshoj të shtoj në nenin 72 pika 4 “në momentin që konfirmohet vendimi, arsyetimi vihet në dispozicion në mënyrë të shkruar i firmosur nga gjyqtarët dhe bëhet publik”. Kjo është ajo ccka pritët nga Gjykata Kushtetuese. Mendoj se kjo është një ndër kritikën më të mëdhaja përkundëjt Gjykatës Kushtetuese. Do të sygjeroja ta shtonim në pikën 4, duke qartësuar që nëse ata e kanë marrë vendimin ky vendim le të publikohet. Flasin për eficcencën e këtij gjyqësori dhe do të sygjeroja që ky të jetë roli i Gjykatës Kushtetuese, pra që vendimet të vendosen në dispozicion menjëherë.

**Fatmir Xhafaj** – Te neni 83 është fjala për arsyetimin e vendimit.

Unë jam shumë dakord me zotin Rainer, por kam vetëm një merak, për aq sa e kuptoj unë, për të mos bërë rolin e ekspertit të Gjykatës Kushtetuese: kur ka çështje delikate, që vjen çështja sot dhe kërkon një përgjigje për tri ditë dhe nuk arrin dot, kur dihet situata e jashtëzakonshme që ka vendimmarrja, a mund të lëmë një afat më të ngushtë? Kjo mund të jetë spekulative, nuk e di, por gjykata mund të shqyrtojë edhe çështje brenda 72 orëve. Atëherë ne do ta detyrojmë të ketë vendimin e arsyetuar?

**Rainer Deville** *-(flet anglisht)* Në këtë rast ne kemi pikën 6 dhe vendimi do të shpallet kur të jetë gati. Mendoj se ky është instrumenti i duhur për Gjykatën Kushtetuese. Ata nuk duhet të vendosin menjëherë, por të marrin kohën për të hartuar vendimin dhe më pas vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i publikuar. Ky është perceptimi publik për Gjykatën Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Ne jemi dakord me sugjerimin, kështu që duhet ta reflektoni në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mbajtur parasysh edhe rastet përjashtimore.

Po, zoti Sadushi.

**Sokol Sadushi** – Kjo çështje nuk është kaq e thjeshtë.

Zoti Rainer ka shumë të drejtë për sa i përket shqetësimit që kanë të gjithë shqiptarët, për të marrë vendimin në kohë nga Gjykata Kushtetuese.

Ky projektligj ka sjellë disa risi që ndoshta edhe duhen pasur në vëmendje. Gjyqtari do të shkojë me projektvendim në vendimmarrje, që sot nuk e ka. Nëse e respekton këtë kusht, që në mbledhjen e gjyqtarëve të shkohet në momentin e votimit me projektvendim, nuk do të lindë asnjëherë problemi që të mos arsyetohet dhe të mos shpallet në kohë. E para.

E dyta, mund të ndodhë të shkojë edhe pa projektvendim. Çdo gjë mund të ndodhë, por situatat mund të jenë të tilla që mund të kërkojnë... Vendimi u mor sot dhe ky vendim ndonjëherë ndodh që e merr vesh edhe media, për fatin e keq, të nxjerrjes së informacionit nga vetë gjyqtarët.

Media e nxjerr dhe gjykata nuk e ka bërë ende vendimin, sepse e ka të pamundur ta bëjë menjëherë. Atëherë fillon deligjitimimi më i rëndë i gjykatës, sepse media thotë: “Gjykata vendosi kështu”, gjyqtarët pyetën, apo kërkohet nga zëdhënësi nëse është shprehur gjykata lidhur me këtë gjë. Zëdhënësi do të thotë, jo nuk është shprehur, sepse nuk ka një vendim të shpallur. Ndërkohë që kjo krijon një lloj shqetësimi të madh.

Prandaj ne kemi sugjeruar që në raste të veçanta dhe kjo varet në përgjegjshmërinë e gjyqtarëve, mund të mos ndalohen të shpallin të paktën diapozitivin, duke i detyruar që afatin e vendimit të arsyetuar ta kenë maksimumi 30 ditë jo më shumë.

Ndërkohë, sot ata e kanë pa afat. Çfarë ndodh? E shpallin sot dispozitivin dhe kjo është bërë abuzive dhe ndoshta këtu është ndërhyrja që Rajner ka të drejtë, shpallja e dispozitivit dhe ai nuk e arsyeton vendimin dhe e lë me muaj të tërë.

Ne nuk duam të ndodhemi në situata që çështja mund të kërkojë urgjencë dhe të shpallet vendimi patjetër sot dhe gjykata ende nuk e ka arsyetuar vendimin. Ky është shqetësimi që duhet të kemi në një rast përjashtimor, por ne nuk gjejmë rast tjetër përveç shpalljes së dispozitivit.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Anastasi, urdhëroni!

**Aurela Anastasi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që Sokoli ka shprehur shqetësime të drejta, por në këtë kuadër do të preferoja më mirë që ne të jemi të vendosur, në kuptimin që kur të shpallim vendimin, ta shpallim të arsyetuar. Ndoshta do të ishte më mirë të gjenim një formulë sikurse e ka gjetur Kodi i Procedurës Civile, i cili e shtyn ditën e shpalljes së vendimit. Pra, mund të shtyjme datën e shpalljes së vendimit, me qëllim që vendimi kur të shpallet, të shpallet i arsyetuar.

Kjo mund të realizojë edhe atë që thatë ju në rastet e veçanta, siç ishte rasti i procedurës për votëbesimin e qeverisë në parlament, që u gjykua brenda 72 orëve.

Kështu e mendoj unë.

Zoti Rainer ka absolutisht të drejtë kur thotë që këtu vendimi duhet të shpallet i arsyetuar, por ne duhet të menaxhojmë edhe risqet.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. A mund ta rishikoni dhe ta riformuloni bashkë me zotin Deville që të krijojmë një ekuilibër këtu, sepse ne kemi pasur raste nga Gjykata Kushtetuese, që kanë qenë shqetësuese.

**Sokol Sadushi** – Ka qenë e kundërt. Gjykata e ka bërë vendimin brenda natës. Unë do të thosha, nëse mund t’ju sugjerojmë, që e vetmja zgjidhje mund të jetë, është e sforcuar, të mos ndalohet shpallja e dispozitivit, por të paktën afati të mos jetë 30 ditë, por 5 ditë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Bisedojeni!

**Sokol Sadushi** – Është pak e sforcuar, por të paktën...

**Fatmir Xhafaj** – Bisedojeni, vendoseni dhe na njoftoni, sepse është teknike. Në parim biem dakord. E mbështesim propozimin e zotit Devil, por ju shikoni një zgjidhje teknike.

Neni 84.

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, e kam pyetjen për zotin Sadushi. Ju thoni: “Kur gjatë votimit nuk formohet shumica prej 5 anëtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar”.

**Sokol Sadushi** – Është fjala për kërkesat e individëve.

**Vasilika Hysi** – Mund të kem një kërkesë të drejtë. Nuk bëhen 5 gjyqtarë ti nuk mund ta djegësh kërkesën. Nuk është shkak. Nuk duan ata. Atëherë, duhet

riformuluar, sepse kështu siç është thënë, i bie që kërkesa konsiderohet e rrëzuar pa u gjykuar ende, sepse nuk bëhet shumica...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin, me riformulimin.

Neni 85, që shfuqizon 74-ën.

Dakord.

Neni 86 efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Dakord.

Neni 87, që shfuqizon 77-ën.

Dakord.

Neni 88, që ndryshoi numërtimet, por thjesht po i lexoj sipas projektit, që shfuqizon 79.

Dakord.

Neni 89 që ndryshon 88-ën saktësimi dhe plotësimi i vendimit.

Dakord.

Neni 90 që ndryshon paragrafët 3 dhe 4 të nenit 81, lidhur me ekzekutimin e vendimeve.

Dakord.

Neni 91 që shfuqizon nenet 82, 83, 94 85.

Dakord.

Neni 92 që ndryshon 86-ën, zbatimin e ligjit të ri, që do të thotë që do të vendoset numri dhe data e ligjit që do të kalojë.

Urdhëroni, te neni 92?

**Sokol Sadushi** – Te neni 92 është e vërtetë që ne kemi vendosur të gjitha dispozitat, por do të na mirëkuptoni se do të ketë ndryshim në këto dispozita, në referenca, sepse nuk janë të sakta të gjitha.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet e nenit 92 duke bërë riformulimet?

Neni 93 hyrja në fuqi e ligjit.

Dakord.

E mbylлим këtu shqyrtimin nen për nen me nenet që kemi lënë të hapura për t'i diskutuar apo për të reflektuar ndryshimet që u bënë gjatë debatit, në mënyrë që gjatë votimit të fundit t'i shikojmë me qetësi.

Kështu që do t'i japim kohën e nevojshme grupit të ekspertëve, por edhe ne që të kemi mundësi ta lexojmë nenin në qetësi të plotë në tërë koherencën e tij dhe pastaj për ta votuar në tërësi.

E mbyllim këtu.

Shumë faleminderit për durimin, kontributin dhe mbi të gjitha për punën e jashtëzakonshme që keni bërë, zonja Anastasi, zoti Devil, zoti Sadushi, zonja Vorpsi, zonja Hazbiu, këshilltarët e komisionit, gjithashtu, që kanë ndihmuar! Falënderoj edhe zonjat shumë të nderuara që na shërbyen me përkthimin!

Edhe një herë, faleminderit! Punë të mbarë!

Ditën e premte vazhdojmë sipas kalendarit.

## **MBLEDHJA MBYLLET**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*